

Ebu Hamid Muhammed el-Gazali

VËREJTJE
DHE
KËSHILLA

Shqipëroi: Muhamed I. Dolaku



Mitrtovicë, 2009

Ebu Hamid Muhammed El-Gazali
El-Meva'idh fi'l-ehadithi'l-kudsijje

Recensent:

Lektor:

Korrektor:

Botoi:

PARATHËNIE

*Në emër të All-llahut, të Gjithmëshirshmit,
Mëshiruesit!*

Falënderimi i qoftë All-llahut xh.sh. për Paralajmërimin që ua ka dërguar robërve të Tij dhe me të i ka inkurajuar muslimanët e devotshëm për ibadet! Bekimi qoftë mbi të Parin e fesë së pastër e kënaqësia (e All-llahut) mbi familjen e tij, as'habët e tij dhe familjet e tyre si dhe mbi ata që i pasojnë në të mirë dhe mbi dijetarët e Ummetit në të gjitha kohët!

Ky libër ngërthen në vete shumë gjëra të mira dhe të dobishme, e dhashtë All-llahu që të përfitojmë nga këto!

Këshilla e parë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! عَجِبْتُ لِمَنْ أَتَقَنَ بِالْمَوْتِ
 كَيْفَ يَفْرَحُ، وَ عَجِبْتُ لِمَنْ أَتَقَنَ بِالحِسَابِ كَيْفَ
 يَجْمَعُ المَالَ، وَ عَجِبْتُ لِمَنْ أَتَقَنَ بِالقَبْرِ كَيْفَ يَضْحَكُ،
 وَ عَجِبْتُ لِمَنْ أَتَقَنَ بِالْآخِرَةِ كَيْفَ يَسْتَرْيَحُ، وَ عَجِبْتُ
 لِمَنْ أَتَقَنَ بِالدُّنْيَا وَ زَوَالِهَا كَيْفَ يَطْمَئِنُّ إِلَيْهَا، وَ عَجِبْتُ
 لِمَنْ هُوَ عَالِمٌ بِاللِّسَانِ جَاهِلٌ بِالقَلْبِ، وَ عَجِبْتُ لِمَنْ
 يَطْهَرُ بِالمَاءِ وَ هُوَ غَيْرُ طَاهِرٍ بِالقَلْبِ، وَ عَجِبْتُ لِمَنْ
 يَشْتَغِلُ بِعُيُوبِ النَّاسِ وَ هُوَ غَافِلٌ عَنِ عُيُوبِ نَفْسِهِ، أَوْ
 لِمَنْ يَعْلَمُ أَنَّ اللَّهَ تَعَالَى مُطَّلِعٌ عَلَيْهِ كَيْفَ يَعْصِيهِ، أَوْ لِمَنْ
 يَعْلَمُ أَنَّهُ يَمُوتُ وَحْدَهُ، وَ يَدْخُلُ القَبْرَ وَحْدَهُ، وَ يُحَاسِبُ
 وَحْدَهُ، كَيْفَ يَسْتَأْنِسُ بِالنَّاسِ، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا حَقًّا، وَ أَنَّ
 مُحَمَّدًا عَبْدِي وَ رَسُولِي

All-llahu i Lartmadhërishëm ka thënë¹: "O njeri!

¹ Para çdo hadithi kudsij gjenden fjalët paraprake, të cilat ne, në përkthim i kemi anashkaluar, meqë nënkuptohen

Habitem me atë njeri, i cili është i bindur se do të vdesë, sesi mund të dëfrehet! Habitem me atë njeri, i cili është i bindur se do të japë llogari, sesi mund të mbledhë (tubojë) pasuri! Habitem me atë njeri, i cili është i bindur se do të vendoset në varr, sesi mund të qeshë! Habitem me atë njeri, i cili është i bindur për ahiretin, sesi mund të pushojë! Habitem me atë njeri, i cili është i bindur për këtë botë dhe për zhdukjen e saj, e si atëherë mund të gjejë prehje në të! Habitem me atë njeri, i cili është i njohur për nga gjuha (në të folur) e është xhahil (i paditur) në zemër! Habitem me atë njeri, i cili pastrohet me ujë, e zemrën e ka të papastër! Habitem me atë njeri, të cilin e kanë kapluar mëkatet (mangësitë) e njerëzve të tjerë, e është i pakujdesshëm kundrejt të metave (mangësive) të veta, ose me atë i cili e di se është i mbikëqyrur nga All-llahu, e së këndejmi është i padëgjueshëm ndaj Tij, ose me atë i cili e di se do të vdesë vetëm, do të hyjë na varr vetëm, dhe vetë do të japë llogari, sesi mund të shoqërohet me njerëzit! Nuk ka Zot tjetër përveç Meje, të Njëmendshëm, e Muhamedi është robi Im dhe i Dërguari Im! "

Këshilla e dytë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: شَهِدْتُ نَفْسِي، أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا
وَحْدِي، لَا شَرِيكَ لِي، مُحَمَّدٌ عَبْدِي وَرَسُولِي. مَنْ لَمْ
يَرْضَ بِقَضَائِي، وَلَمْ يَصْبِرْ عَلَى بَلَائِي، وَلَمْ يَشْكُرْ عَلَى
نِعْمَائِي، وَلَمْ يَقْنَعْ بِعَطَائِي، فَلْيَعْبُدْ رَبًّا سِوَايَ، وَمَنْ
أَصْبَحَ حَزِينًا عَلَى الدُّنْيَا فَكَأَنَّمَا أَصْبَحَ سَاحِطًا عَلَى، وَ
مِنْ اشْتَكَى عَلَى مُصِيبَةٍ فَقَدْ شَكَانِي، وَمَنْ دَخَلَ عَلَى
غَنِيٍّ فَتَوَاضَعَ لَهُ مِنْ أَجْلِ غِنَائِهِ ذَهَبَ ثُلَاثًا دِينَهُ، وَمَنْ
لَطَمَ وَجْهَهُ عَلَى مَيِّتٍ فَكَأَنَّمَا أَخَذَ رُمْحًا يُقَاتِلُنِي بِهِ، وَ
مَنْ كَسَرَ عُودًا عَلَى قَبْرِ فَكَأَنَّمَا هَدَمَ بَابَ كَعْبَتِي بِيَدِهِ، وَ
مَنْ لَمْ يُبَالِ مِنْ أَيِّ بَابٍ يَأْكُلُ، مَا يُبَالِي مِنْ أَيِّ بَابٍ
يُدْخِلُهُ اللَّهُ تَعَالَى جَهَنَّمَ، وَمَنْ لَمْ يَكُنْ فِي الزِّيَادَةِ فِي
دِينِهِ فَهُوَ فِي النُّقْصَانِ، وَمَنْ كَانَ فِي النُّقْصَانِ فَالْمَوْتُ
خَيْرٌ لَهُ، وَمَنْ عَمِلَ بِمَا عَلِمَ أَوْرَثَهُ اللَّهُ تَعَالَى عِلْمَ مَا لَمْ
يَعْلَمْ، وَمَنْ أَطَالَ أَمَلُهُ لَمْ يَخْلُصْ عَمَلُهُ

"Dëshmoj me Veten Time se nuk ka Zot tjetër përveç Meje dhe se nuk kam shok! Muhamedi është robi Im dhe i Dërguari Im! Ai që nuk është i kënaqur me përcaktimin Tim dhe nuk është i durueshëm për sprovimin Tim, është i pakënaqur me dhuntitë e Mia dhe nuk kënaqet me atë që jap Unë, le ta adhurojë ndonjë sundues tjetër pos Meje! Ai që gdhinë i pikëlluar për shkak të dunjallëkut, ai sikur të ketë gdhirë i hidhëruar në Mua! Ai që ankohet në mynxyrat, ai ankohet në Mua! Kush hyn tek ndonjë i pasur e i bindet atij për shkak pasurisë së tij, ai e ka humbur një të tretën e besimit të vet! Kush e godet fytyrën e vet për shkak të ndonjë të vdekuri, ai sikur ta ketë marrë një shtizë e të dojë të sulet në Mua! Ai që e thyen një degë në ndonjë var, sikur me dorë të vet ta ketë thyer derën e Kab'es Sime! Ai që nuk kujdeset se nga cila derë do të hajë (ushqehet), as All-llahu nuk do të kujdeset se nga cila derë e Xhehennemit do ta futë (në Zjarr)! Ai i cili nuk e rritë (zmadhon) besimin e vet, ai është në humbje, e kush është në humbje ma mirë e ka të vdesë! Ai që vepron në bazë të asaj që e di, All-llahu do t'ia mësojë atë që nuk e di! Ai që ka shpresa të mëdha, veprën nuk e ka të singertë! "

Këshilla e tretë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! أَفْنَعُ تَسْتَغْنِ، وَ اِتْرُكِ الْحَسَدَ
تَسْتَرْحِ، وَ اجْتَنِبِ الْحَرَامَ تُخْلِصَ دِينَكَ، وَ مَنْ تَرَكَ
الْغَيْبَةَ ظَهَرَتْ لَهُ مَحَبَّتِي، وَ مَنْ اعْتَزَلَ النَّاسَ سَلِمَ مِنْهُمْ،
وَ مَنْ قَلَّ كَلَامُهُ كَمَلَ عَقْلُهُ، وَ مَنْ رَضِيَ بِالْقَلِيلِ فَقَدْ
وَقِيَ بِاللَّهِ تَعَالَى. يَا بَنَ آدَمَ! أَنْتَ بِمَا تَعْلَمُ لَا تَعْمَلُ،
فَكَيْفَ تَطْلُبُ عِلْمَ مَا لَا تَعْلَمُ؟ يَا بَنَ آدَمَ! تَعْمَلُ فِي الدُّنْيَا
كَأَنَّكَ لَا تَمُوتُ غَدًا، وَ تَجْمَعُ الْمَالَ كَأَنَّكَ مُخَلَّدٌ أَبَدًا.
يَا دُنْيَا احْرِمِي الْحَرِيسَ عَلَيْكَ، وَ ابْتَغِي الزَّاهِدَ فِيكَ، وَ
كُونِي حُلُوءَةً فِي عَيْنِ النَّاطِرِينَ

"O njeri! Ji i kënaqur me atë që ke, do të jeshë më i pasuri! Shmangiu zilisë do të jeshë më i rehatshmi! Largohu nga harami, do ta ruash besimin tënd! Kush e braktisë shpifjen, (delendisjen), do t'i shprehet dashuria Ime! Kush ruhet nga njerëzit, do të shpëtojë nga ata! Kush e zvogëlon të folurit, mendja i përmbushet! Kush është i kënaqur me pak, ai

mbështetet tek All-llahu! O njeri! Ti nuk je duke vepruar sipas asaj që e di, e pse atëherë kërkon atë që nuk e di!? Po punon për këtë botë sikur nuk do të vdesësh nesër dhe grumbullon pasuri sikur do të jetosh përgjithmonë! O dunjallëk! Shkurtohu për atë që është i pangopshëm me ty, gjako (lakmo) për atë që s'çan kokën për ty, e bëhu i ëmbël për ata që të shikojnë! "

Këshilla e katërt

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! مَنْ أَصْبَحَ حَزِينًا عَلَى الدُّنْيَا
لَمْ يَزِدْ مِنْ اللَّهِ إِلَّا بُعْدًا، وَفِي الدُّنْيَا إِلَّا كَدًّا، وَفِي
الْآخِرَةِ إِلَّا جَهْدًا، وَالْزَمَ اللَّهُ تَعَالَى قَلْبُهُ هَمًّا لَا يَنْقَطِعُ
عَنْهُ أَبَدًا، وَشُغْلًا لَا يَفْرُغُ عَنْهُ أَبَدًا، وَفَقْرًا لَا يَنَالُ غِنًى
أَبَدًا، وَآمَالًا تَشْغُلُهُ أَبَدًا. يَا بَنَ آدَمَ! تَنْقُصُ كُلَّ يَوْمٍ مِنْ
عُمْرِكَ وَأَنْتَ لَا تَدْرِي، وَآتِيكَ كُلَّ يَوْمٍ بِرِزْكَ وَأَنْتَ
لَا تَحْمَدُ، فَلَا بِالْقَلِيلِ تَقْنَعُ، وَلَا بِالكَثِيرِ تَشْبَعُ. يَا بَنَ
آدَمَ! مَا مِنْ يَوْمٍ إِلَّا وَيَأْتِيكَ رِزْقُكَ مِنْ عِنْدِي، وَمَا مِنْ
لَيْلَةٍ إِلَّا وَيَأْتِيَنِي الْمَلَائِكَةُ مِنْ عِنْدِكَ بِعَمَلٍ قَبِيحٍ، تَأْكُلُ
رِزْقِي وَتَعْصِيَنِي، وَأَنْتَ تَدْعُونِي فَأَسْتَجِيبُ لَكَ، وَ
خَيْرِي إِلَيْكَ نَازِلٌ، وَشُرُكَ إِلَيَّ وَاصِلٌ، فَنِعَمَ الْمَوْلَى أَنَا
لَكَ! وَبِئْسَ الْعَبْدُ أَنْتَ لِي! تَسْتَلْنِي مَا أُعْطِيكَ، وَأَسْتُرُ
عَلَيْكَ سَوَاءَ بَعْدَ سَوَاءٍ فَضِيحَةٍ، وَأَنَا أَسْتَحْيِي مِنْكَ وَ

أَنْتَ لَا تَسْتَحْيِي مِنِّي، تَنْسَانِي وَتَذَكُرُ غَيْرِي، وَتَخَافُ
النَّاسَ وَتَأْمَنُ مِنِّي، وَتَخَافُ مَقْتَهُمْ، وَتَأْمَنُ غَضَبِي

"Kush gdhin i pikëlluar për shkak të dunjallëkut, ai do të largohet nga All-llahu, në dunjallëk do të ketë vetëm vuajtje, e në ahiret përpjekje të kota! All-llahu do t'ia rëndojë (ngarkojë) zemrën me brenga, të cilat kurrë nuk do të pushojnë, me punë, të cilat kurrë nuk do të ndërpriten, me varfëri, e cila kurrë nuk do të anulohet dhe me shpresa, të cilat kurrë nuk do të zhदारariten! O njeri! Për çdo ditë të pakësohet nga jeto jote, e ti nuk çan kokën për këtë, për çdo ditë të vjen nafaka, e t'i sërish je mosmirënjohës! Nëse të pakësohet, je i pakënaqur, nëse të shumohet je i pangopshëm! O njeri! Për çdo ditë të vjen nafaka nga Unë, e për çdo natë nga ti Mua më vijnë engjëjt me veprat e tua të shëmtuara! Po ushqehesh me furnizimin Tim, e nuk Më je mirënjohës! Ti më thërret, e Unë të përgjigjem! Të mirat e Mia të zbresin ty, e Mua më vijnë të këqijat e tua! E, sa Sundimtar i mirë që jam Unë ndaj teje, e sa rob i keq që je ti ndaj Meje! Ti harron atë që të jap Unë, e Unë po i mbuloj turpet e tua! Unë turpërohem prej teje, e ti nuk turpërohesh prej Meje! Mua më harron, e tjetrin kujton (mendon)! Ki frikë nga njerëzit dhe pezmi i tyre, e ji i sigurt nga Unë dhe pezmi Im! "

Këshilla e pestë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! لَا تَكُنْ مِمَّنْ يُقَصِّرُ التَّوْبَةَ، وَ
يُطَوِّلُ الْأَمَلَ، وَيَرْجُو الْآخِرَةَ بِغَيْرِ عَمَلٍ؛ يَقُولُ قَوْلَ
الْعَابِدِينَ وَ يَعْمَلُ عَمَلَ الْمُنَافِقِينَ. إِنْ أُعْطِيَ لَمْ يَقْنَعْ، وَ
إِنْ مُنِعَ لَمْ يَصْبِرْ. يَأْمُرُ بِالْخَيْرِ وَ لَا يَفْعَلُهُ، وَ يَنْهَى بِالشَّرِّ
وَ لَمْ يَنْتَهِ عَنْهُ. يُحِبُّ الصَّالِحِينَ وَ لَيْسَ مِنْهُمْ، وَ يَبْغِضُ
الْمُنَافِقِينَ وَ هُوَ مِنْهُمْ. يَقُولُ مَا لَا يَفْعَلُ، وَ يَفْعَلُ مَا لَا
يُؤْمَرُ، وَ يَسْتَوْفِي مَا لَا يُوفَى. يَا بَنَ آدَمَ! مَا مِنْ يَوْمٍ جَدِيدٍ
إِلَّا وَ الْأَرْضُ تُخَاطِبُكَ فِي قَوْلِهَا تَقُولُ لَكَ: يَا بَنَ آدَمَ!
تَمْشِي عَلَى ظَهْرِي، ثُمَّ تُخَزِّنُ فِي بَطْنِي، وَ تَأْكُلُ
الشَّهَوَاتِ عَلَى ظَهْرِي، وَ يَأْكُلُكَ الدُّودُ فِي بَطْنِي. يَا بَنَ
آدَمَ! أَنَا بَيْتُ الْوَحْشَةِ، وَ أَنَا بَيْتُ الْمُسَاءَلَةِ، وَ أَنَا بَيْتُ
الْوَحْدَةِ، وَ أَنَا بَيْتُ الظُّلْمَةِ، وَ أَنَا بَيْتُ الْحَيَاتِ وَ
الْعَقَارِبِ، فَاعْمُرْنِي وَ لَا تُخَرِّبْنِي

"O njeri! Mos u bëj prej atyre të cilët zvogëlojnë vështirësitë, e e zgjasin shpresën, e as prej atyre të cilët e shpresojnë ahiretin pa kurrfarë veprash, të cilët flasin me fjalët e të devotshmëve, e veprojnë me vepra të hipokritëve! Nëse u jepet, nuk janë të kënaqur, e nëse u cungohet, nuk janë të durueshëm! Urdhërojnë të bëhen vepra të mira, e vetë nuk i bëjnë dot, ndalojnë ato të këqijat, e vetë nuk pushojnë së bëri! I duan bamirësit, e vetë nuk janë prej tyre, i urrejnë hipokritët, ndërsa vetë janë të tillë, flasin atë që nuk punojnë, e punojnë atë për çka nuk janë të urdhëruar, kërkojnë nga të tjerët, e vetë nuk i zbatojnë detyrimet! O njeri! Nuk kalon dot as një ditë e vetme e që Toka të të mos drejtohet me këto fjalë: 'O njeri! Po ecë nëpër mua, e pastaj do të shtrihesh në mua, po ha nga unë, e pastaj ty do të të hanë krimbat në mua! O njeri! Unë jam Shtëpia e vetmisë, dhe Shtëpia e marrjes në pyetje, dhe Shtëpia e izolimit dhe e errësirës, dhe Shtëpia e gjarpërinjve dhe i akrepave (sfurkthëve), andaj mos më rrëno, por më ndërto!'"

Këshilla e gjashtë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ مَا خَلَقْتُكُمْ لِأَسْتَكْبِرَ بِكُمْ مِنْ قَلَّةٍ، وَلَا لِأَسْتَأْنِسَ بِكُمْ مِنْ وَحْشَةٍ، وَلَا لِأَسْتَعِينَ بِكُمْ عَلَى أَمْرِ عَجِزْتُ عَنْهُ، وَلَا لِجَلْبِ مَنَفَعَةٍ، وَلَا لِدَفْعِ مَضَرَّةٍ، بَلْ خَلَقْتُكُمْ لِتَعْبُدُونِي طَوِيلًا، وَتَشْكُرُونِي كَثِيرًا، وَتُسَبِّحُونِي بُكْرَةً وَأَصِيلًا. يَا بَنَ آدَمَ! لَوْ أَنَّ أَوَّلَكُمْ وَآخِرَكُمْ، وَجَنَّتُمْ وَإِنْسَكُمْ، وَصَغِيرَكُمْ وَكَبِيرَكُمْ، وَحُرَّكُمْ وَعَبْدَكُمْ، اجْتَمَعُوا عَلَى طَاعَتِي مَا زَادَ ذَلِكَ فِي مُلْكِي مِثْقَالَ ذَرَّةٍ. وَمَنْ جَاهَدَ فَإِنَّمَا يَجَاهِدُ لِنَفْسِهِ، إِنَّ اللَّهَ لَغَنِيٌّ عَنِ الْعَالَمِينَ. يَا بَنَ آدَمَ! كَمَا تُؤْذِي تُؤْذَى بِكَ، وَكَمَا تَعْمَلُ يُعْمَلُ بِكَ

"O njerëz! Nuk ju kam krijuar për tu forcuar me shumësinë tuaj, as për tu shoqëruar me ju për shkak të vetmisë Sime, as për tu ndihmuar me fuqinë tuaj, e as për të prokuruar ndonjë dobi nga ju ose për të shmangur ndonjë mynxyrë, por ju kam krijuar që të Më robëroheni gjatë, që të Më falënderoni shumë

dhe që të Më madhëroni edhe në mëngjes edhe në mbrëmje! O Njerëz! Sikur të ishit bashkuar të gjithë ju dhe xhinët, të rinjtë dhe pleqtë, të lirët dhe robërit, për t'Mu bindur Mua, kjo nuk do ta zmadhonte as për një thërmijë pushtetin Tim! Kush përpiqet (mundohet), ai përpiqet për dobi të vetë, e All-llahu, me të vërtetë, është i pavarur nga njerëzit! O njeri! Ashtu siç e trazon (shqetëson) ti dikënd, ashtu do të jeshë edhe ti i trazuar, dhe si të sillesh ti ndaj dikujt, ashtu do të sillen edhe të tjerët ndaj teje! "

Këshilla e shtatë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! يَا عِيَدَ الدِّينَارِ وَ الدَّرَاهِمِ!
 إِنِّي خَلَقْتُهُمَا لَكُمْ لِتَأْكُلُوا بِهِمَا رِزْقِي، وَ تَلْبَسُوا بِهِمَا
 ثِيَابِي، وَ تُسَبِّحُونِي وَ تُقَدِّسُونِي؛ ثُمَّ تَأْخُذُونَ كِتَابِي وَ
 تَجْعَلُونَهُ وَرَاءَكُمْ، وَ تَأْخُذُونَ الدِّينَارَ وَ الدَّرَاهِمَ وَ
 تَجْعَلُونَهَا فَوْقَ رُءُوسِكُمْ، وَ رَفَعْتُمْ يُّوْتَكُمْ وَ خَفَضْتُمْ
 يُّوْتِي، فَلَا أَنْتُمْ أَحْيَاءُ وَ لَا أَنْتُمْ أَمْوَاتٌ؛ أَنْتُمْ عِيَدُ الدُّنْيَا،
 وَ اجْتِمَاعُ مِثْلِكُمْ كَمِثْلِ الْقُبُورِ الْمُجَصَّصَةِ، يُرَى ظَاهِرُهَا
 مَلِيحًا وَ بَاطِنُهَا قَيْحًا، وَ كَذَا تُصَلِّحُونَ لِلنَّاسِ وَ تُحْبُونَ
 إِلَيْهِمْ بِالنِّسْتِكُمْ الْحُلُوةِ، وَ أَفْعَالِكُمْ الْجَمِيلَةِ، وَ تُبَاعِدُونَ
 بِقُلُوبِكُمُ الْقَاسِيَةَ وَ أَحْوَالِكُمُ الْخَبِيثَةَ. يَا بَنَ آدَمَ! أَخْلِصْ
 عَمَلَكَ وَ اسْأَلْنِي! فَإِنِّي أُعْطِيكَ أَكْثَرَ مِمَّا يَطْلُبُ السَّائِلُونَ

"O njerëz! O shërbëtorë të dinarit dhe të dërhemit! Unë ato i kam krijuar për ju që, me ndihmën e tyre, të ushqeheni me furnizimin Tim, që të visheni me rrobat e Mia, dhe për të Më madhëruar dhe adhuruar. Ju keni pranuar (pëlqyer) Librin Tim,

e pastaj atë e keni hedhur pas shpine, e dinarin dhe dërhemin i keni marrë dhe i keni vendosur mbi të gjitha! I keni ngritur shtëpitë tuaja, ndërsa shtëpitë e Mia i keni poshtëruar! Ju nuk jeni njerëz të shquar, e as njerëz të lirë, porse vetëm robër të parasë. Tubimet tuaja janë sikurse varret e gëlqerosura, me pamje të jashtme të bukur, por me brendi të papëlqyeshme! Po e përmirësoni gjendjen mes njerëzve, duke u shprehur dashuri me fjalë të ëmbla dhe duke u sjellë bukur me ta, porse po largoheni nga ngurtësia e zemrave tuaja dhe nga hallet/gjendjet tuaja të urryera! O njeri! Vepra singlerisht dhe më lut Mua, se Unë, me të vërtetë, do të të dhuroj më shumë sesa Më lusin lutësit e Mi! "

Këshilla e tetë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! مَا خَلَقْتُكُمْ عَبَثًا، وَلَا خَلَقْتُكُمْ سُدًى، وَمَا أَنَا بِغَافِلٍ، وَإِنِّي بِكُمْ خَبِيرٌ. وَلَنْ تَنَالُوا مَا عِنْدِي إِلَّا بِالصَّبْرِ عَلَى مَا تَكْرَهُونَ فِي رِضَائِي، وَالصَّبْرُ لَكُمْ عَلَى طَاعَتِي أَيْسَرُ لَكُمْ مِنَ الصَّبْرِ عَلَى مَعْصِيَتِي، وَتَرْكُ الذَّنْبِ أَيْسَرُ لَكُمْ مِنْ اعْتِدَارِي مِنْ حَرِّ النَّارِ، وَعَذَابِ الدُّنْيَا أَيْسَرُ لَكُمْ مِنْ عَذَابِ الْآخِرَةِ، يَا بَنَ آدَمَ! كُلُّكُمْ ضَالٌّ إِلَّا مَنْ هَدَيْتُهُ، وَكُلُّكُمْ مُسِيءٌ إِلَّا مَنْ عَصَمْتُهُ، وَتَوَبُّوا إِلَيَّ أَرْحَمَكُمُ، وَلَا تَهْتِكُوا أَسْرَارَكُمْ عِنْدَ مَنْ لَا يَخْفَى عَلَيْهِ سِرُّكُمْ

"O njerëz! Unë nuk ju kam krijuar juve ngase m'u ka tekur, e as kot për së koti (pa ndonjë shkak a arsye të rëndësishme), e as që jam i pakujdesshëm kundrejt asaj çfarë bëni ju! Unë jam i informuar mirë për të gjitha! Nuk do të arrini dot atë që dëshironi nga Unë, përveç me durim kundrejt asaj që e urreni për hir të kënaqësisë Time! Më lehtë e keni të jeni të durueshëm në të bindur ndaj Meje, sesa në të pabin

dur ndaj Meje! Më lehtë e keni të braktisni mëkatin sesa të arsyetoheni nga vapa e Xhehennemit! Më lehtë për ju është vuajtja e dunjasë sesa vuajtja e ahiretit! Ju të gjithë jeni në lajthitje, përveç atyre që i udhëzoj Unë! Të gjithë jeni mëkatarë, përveç atyre që i mbroj Unë! Për mëkatet tua kërkon ndjesë nga Unë, se do t'ju mëshiroj! Mos fshihni sekretet tua nga Ai, për të Cilit sekretet tua nuk janë të panjohura! "

Këshilla e nëntë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! لَا تَلْعَنُوا الْمَخْلُوقِينَ فَتَرَدَّ
 اللَّعْنَةُ عَلَيْكُمْ. يَا بَنَ آدَمَ! اسْتَقَامَتِ السَّمَاوَاتُ فِي الْهَوَاءِ
 بِلاَ عَمَدٍ بِاسْمِ وَاحِدٍ مِنْ أَسْمَائِي، وَلَمْ تَسْتَقِمْ قُلُوبُكُمْ
 بِإِلْفِ مَوْعِظَةٍ مِنْ كِتَابِي. يَا أَيُّهَا النَّاسُ! كَمَا لَا يَلِينُ
 الْحَجَرُ فِي الْمَاءِ، كَذَلِكَ لَا تُؤَثِّرُ الْمَوْعِظَةُ فِي الْقُلُوبِ
 الْقَاسِيَةِ. يَا بَنَ آدَمَ! كَيْفَ تَشْهَدُونَ أَنَّكُمْ عِبَادُ اللَّهِ ثُمَّ
 تَعَصُونَهُ؟ وَكَيْفَ تَزْعُمُونَ أَنَّ الْمَوْتَ حَقٌّ وَأَنْتُمْ لَهُ
 كَارِهُونَ، وَتَقُولُونَ بِالسِّنِّتِ كُمْ مَا لَيْسَ لَكُمْ بِهِ عِلْمٌ وَ
 تَحْسِبُونَهُ هَيِّنًا وَهُوَ عِنْدَ اللَّهِ عَظِيمٌ

"O bijtë e Ademit! Mos i mallkoni krijesat, që të mos ju kthehet juve ky mallkim! O bijtë e Ademit! Qiejt qëndrojnë pa shtylla² në njërin nga emra e Mi,

² Në suren *Er-Rad*, ajeti 2 qëndron: "*All-llahu është Ai që qiejt, që i shihni ju, i ka ngritur pa shtylla, e ka mbizotëruar Arshin, dhe ka nënshtruar Diellin dhe Hënën. Të gjitha këto rrotullohen për kohë të caktuar. Ai drejton të gjitha dhe i shpjegon argumentet, për t'u bindur ju që (me*

e zemrat tuaja nuk janë të qëndrueshme kundrejt një mijë vërejtjeve nga Libri Im! O njerëz! Ashtu siç guri nuk zbutet në ujë, ashtu edhe në zemrat tuaja të vrazhdta nuk ndikojnë këshillat! O bijtë e Ademit! Si mund të dëshmoni se jeni robërit e All-llahut, e pastaj bëni gabime ndaj Tij? Si është e mundur që të pohoni se vdekja është e vërtetë, e së këndejmi jeni mospërfillës ndaj saj? Ju flisni me gojët tuaja për atë që nuk keni kurrfarë njohurie, dhe këtë e konsideroni si të parëndësishme, porse tek All-llahu kjo është shumë e madhe!³

siguri) do të takoheni me Zotin tuaj. " Në ajetin 10 të sures Lukman qëndron: "**(Ai) ka krijuar qiejt që i shihni ju pa shtylla...**"

³ Marrë nga ajeti 15 i sures En-Nur: "**Atëherë kur atë (shpifjen) e përcillnit me gjuhët tuaja dhe flisnit me gojët tuaja atë për të cilën nuk kishit kurrfarë dijenie, ju këtë e merrnit për cikërrimë, por tek All-llahu — kjo është (çështje) shumë e madhe.** "

Këshilla e dhjetë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: ﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَكُمْ مَوْعِظَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَشِفَاءٌ لِّمَا فِي الصُّدُورِ﴾ (يونس: 57) فَلِمَ لَا تُحْسِنُونَ إِلَّا لِمَن أَحْسَنَ إِلَيْكُمْ، وَلَا تَصِلُونَ إِلَّا مَن وَصَلَكُمْ، وَلَا تُكَلِّمُونَ إِلَّا مَن كَلَّمَكُمْ، وَلَا تُطْعَمُونَ إِلَّا مَن أَطْعَمَكُمْ، وَلَا تُكْرِمُونَ إِلَّا مَن أَكْرَمَكُمْ؟ وَلَيْسَ لِأَحَدٍ عَلَى أَحَدٍ فَضْلٌ، إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ آمَنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ، الَّذِينَ يُحْسِنُونَ إِلَى مَن أَسَاءَ إِلَيْهِمْ، وَ يَصِلُونَ مَن قَطَعَهُمْ، وَ يَغْفُونَ عَمَّن حَرَمَهُمْ، وَ يَأْتِمِنُونَ مَن خَانَهُمْ، وَ يُكَلِّمُونَ مَن هَجَرَهُمْ، وَ يُكْرِمُونَ مَن أَهَانَهُمْ، وَ إِنِّي بِكُمْ لَخَبِيرٌ

"O njerëz, ju ka ardhur juve nga Zoti juaj mësimi dhe ilaçi për atë që keni në kraharorët tuaj. Përse i bëni mirësi vetëm atij që ju ka bërë juve mirësi, përse i mirëmbani lidhjet vetëm me atë që i mirëmban me ju, flisni vetëm me atë që flet me ju, e ushqeni vetëm atë që ju ushqen juve, i shprehni respekt vetëm atij që ju respekton edhe juve? Ju nuk

keni përparësi kundrejt njëri-tjetrit! Ndërsa besimtarë janë vetëm ata të cilët e besojnë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, dhe të cilët i bëjnë mirësi edhe atyre që u bëjnë dëm (ndonjë të keqe), dhe të cilët mirëmbajnë lidhjet edhe me ata që i ndërprejnë këto, dhe të cilët u falin edhe atyre që u kanë bërë padrejtësi, dhe të cilët kanë besim edhe tek ata që i kanë tradhtuar, dhe të cilët flasin edhe me ata që u shmangen, dhe të cilët u shprehin respekt edhe atyre që i përçmojnë! Unë, me të vërtetë, jam i informuar mirë për ju! "

Këshilla e njëmbëdhjetë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا أَيُّهَا النَّاسُ! إِنَّمَا الدُّنْيَا دَارٌ لِمَنْ لَا دَارَ لَهُ، وَ مَالٌ لِمَنْ لَا مَالَ لَهُ، وَ لَهَا يَجْمَعُ مَنْ لَا عَقْلَ لَهُ، وَ بِهَا يَفْرَحُ مَنْ لَا فَهْمَ لَهُ، وَ عَلَيْهَا يَحْرِصُ مَنْ لَا تَوَكُّلَ لَهُ، وَ يَطْلُبُ شَهَوَاتِهَا مَنْ لَا مَعْرِفَةَ لَهُ؛ فَمَنْ أَرَادَ نِعْمَةً زَائِلَةً، وَ حَيَاةً مُنْقَطِعَةً، فَقَدْ ظَلَمَ نَفْسَهُ وَ عَصَا رَبَّهُ، وَ نَسِيَ الْآخِرَةَ وَ غَرَّتْهُ دُنْيَاهُ، وَ أَرَادَ ظَاهِرَ الْإِثْمِ وَ بَاطِنَ هَذَا. ﴿ إِنَّ الَّذِينَ يَكْسِبُونَ الْإِثْمَ سَيُجْزَوْنَ بِمَا كَانُوا يَقْتَرِفُونَ ﴾ (الأنعام: 120) يَا بَنَ آدَمَ! رَاعُونِي وَ تَاجِرُونِي، وَ عَامِلُونِي وَ أَسْفِلُونِي فِي رِبْحِكُمْ. عِنْدِي مَا لَا عَيْنٌ رَأَتْ، وَ لَا أُذُنٌ سَمِعَتْ، وَ لَا خَطَرَ عَلَى قَلْبِ بَشَرٍ، وَ لَا تَنْفُذُ خَزَائِنِي وَ لَا تَنْقُصُ، وَ أَنَا الْوَهَّابُ الْكَرِيمُ

"O njerëz! Dunjallëku është vendbanimi i atij që vendbanim nuk ka dhe pasuria e atij që pasuri nuk ka! Këtë e tubon ai që mend nuk ka dhe i gëzohet asaj ai që nuk di të kuptojë! Për të lakmon ai i cili mbështetje nuk ka, ndërsa kënaqësitë (ëmbëlsitë) e saj i kërkon vetëm ai që nuk mund dot të perceptojë

drejtë! Ai i cili dëshiron begati të paqëndrueshme dhe jetën kaluese, ai ndaj vetes bën dhunim, gabon ndaj Zotit të vet, harron ahiretin, e dunjallëku e mashtron atë! I këtilli bën mëkate të hapta e të fshehta: '**...Se, me të vërtetë, ata që kanë bërë mëkate, do të ndëshkohen për atë që kanë gabuar.**'⁴ O bijtë e Ademit, le të jem Unë gjithnjë në mendimet tuaja, me Mua bëni tregti⁵, punoni dhe garoni në fitimet tuaja, ngase tek Unë ekzistojnë (gjëra) që sytë nuk i kanë parë, veshët nuk i kanë dëgjuar dhe që zemra e njeriut as që mund t'i paramendoj dot!⁶ Thesaret e Mia as nuk shteren as nuk pakësohen! Unë jam Ai që shpërblen fisnikërisht dhe me bollëk! "

⁴ *El-En'am*, 120.

⁵ All-llahu xh.sh. në ajetin 29 të sures *Fatir* thotë: **"Padyshim, ata që e lexojnë Librin e All-llahut dhe kryejnë namazin, dhe haptazi e fshehurazi japin nga ajo me çka i kemi furnizuar Ne, shpresojnë shpërblimin që nuk do të humbasë assesi"**

⁶ Këtë hadis-kudsiq e shënon Buhariu në kaptinat: *"Teuhid"*, 35; *"Bed'u'l-halk"*, 8; *"Tefsiri i sures 32"*, 1. Muslimi në kaptinat: *"Imani"*, hadithi 313; *"Xhenneti"*, hadithet 2, 3, 4, 5. Tirmidhiu në kaptinat: *"Xhenneti"*, 15, *"Tefsiri i sures 32"*, 3, *"Tefsiri i sures 65"*, 1. Ibn Maxhe në kaptinën *"Zuhd"*, 39. Darimiu në kaptinën: *"Ri-kak"*, 98, 105. Ahmed b. Hanbeli: 2/313, 438, 466, 495.

Këshilla e dymbëdhjetë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! ﴿٤٠﴾ اذْكُرُوا نِعْمَتِيَ الَّتِي أَنْعَمْتُ عَلَيْكُمْ وَأَوْفُوا بِعَهْدِي أُوفِ بِعَهْدِكُمْ وَإِيَّيَ فَآرْهَبُونَ ﴿٤١﴾ (البقرة: 40) كَمَا لَا تَهْتَدِي السَّبِيلَ إِلَّا بِدَلِيلٍ، كَذَلِكَ لَا طَرِيقَ إِلَى الْجَنَّةِ إِلَّا بِعَمَلٍ. وَ كَمَا لَا يُجْمَعُ الْمَالُ إِلَّا بِنَصَبٍ، كَذَلِكَ لَا تَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ إِلَّا بِالصَّبْرِ عَلَى عِبَادَتِي. فَتَقَرَّبُوا إِلَى اللَّهِ بِالتَّوَّافِلِ، وَ اطْلُبُوا رِضَائِي بِرِضَا الْمَسَاكِينِ عَنْكُمْ، وَ ارْغَبُوا إِلَى رَحْمَتِي بِمَجَالِسِ الْعُلَمَاءِ، فَإِنَّ رَحْمَتِي لَا تُفَارِقُهُمْ طَرْفَةَ عَيْنٍ.

قَالَ اللَّهُ تَعَالَى: يَا مُوسَى، اسْمَعْ مَا أَقُولُ، فَالْحَقُّ أَنَّهُ مَنْ تَكَبَّرَ عَلَى مَسْكِينٍ حَشَرْتُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ عَلَى صُورَةِ الذَّرِّ، وَ مَنْ تَوَاضَعَ لَهُ رَفَعْتُهُ فِي الدُّنْيَا وَ الْآخِرَةِ، وَ مَنْ تَعَرَّضَ لِهَتِكِ سِرِّ مَسْكِينٍ حَشَرْتُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ غَيْرَ مَسْتُورٍ سِرَّهُ، وَ مَنْ أَهَانَ فَقِيرًا فَقَدْ بَارَزَنِي بِالْمُحَارَبَةِ، وَ مَنْ يُؤْمِنُ بِي صَافَحْتُهُ الْمَلَائِكَةُ فِي الدُّنْيَا وَ الْآخِرَةِ

"O bijtë e Israilit, kujtoni të mirat e Mia që jua kam dhënë dhe përmbushni premtimin që Ma keni dhënë - edhe Unë do ta përmbush atë që jua kam dhënë (premtimin) dhe frikësohuni vetëm nga Unë."⁷ Ashtu siç nuk mund të përudhet dikush pa udhërrëfyes, po kështu nuk mund ta gjeni rrugën për në Xhennet përpos me vepra të mira! Ashtu siç nuk mund të fitohet pasuria përpos me përpjekje të mëdha, po kështu edhe në Xhennet nuk mund të hyni dot përpos me sabër dhe me ibadet ndaj Meje! Afrohuni All-llahut me nafile! Kërkoni kënaqësinë Time duke i kënaqur të varfrit! Kërkoni mëshirën time duke u shoqëruar me njerëz të ditur, ngase mëshira ime për asnjë çast nuk ndahet (largohet) prej tyre! I Lartmadhërishmi ka thënë: "O Musa! Më dëgjo se çfarë të them! Atë i cili kapardiset (krenohet) para të varfërve, Ditën e Gjykimit do ta ringjall atë si një farëz të vogël! Ndërsa atij që kundrejt tyre sillet me përulësi, do t'ia rris famën (namin) edhe në dunjallëk edhe në ahiret! Kush zbulon (e bën të njohur botërisht) ndonjë fshehtësi të të varfrit, Unë Ditën e Gjykimit do t'ia zbuloj fshehtësinë e tij! Kush e poshtëron ndonjë të varfër, ai më ka shpallur Mua luftë! Kush më beson Mua, melekët do ta përshëndesin (me selam) edhe në dunjallëk edhe në ahiret! "

⁷ El-Bekare, 40.

Këshilla e trembëdhjetë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! كَمْ مِنْ سِرَاجٍ قَدْ أَطْفَأَتْهُ رِيحُ
الْهَوَى، وَ كَمْ مِنْ عَابِدٍ قَدْ أَفْسَدَهُ الْعُجْبُ، وَ كَمْ مِنْ
غَنِيٍّ أَفْسَدَهُ الْغَنَاءُ، وَ كَمْ مِنْ فَقِيرٍ أَفْسَدَهُ الْفَقْرُ، وَ كَمْ
مِنْ صَاحِبٍ أَفْسَدَتْهُ الْعَافِيَةُ، وَ كَمْ مِنْ عَالِمٍ أَفْسَدَهُ
الْعِلْمُ، وَ كَمْ مِنْ جَاهِلٍ أَفْسَدَهُ الْجَهْلُ؛ فَلَوْ لَا مَشَايِخُ
رُكَّعٍ، وَ شَبَابُ خُشَّعٍ، وَ أَطْفَالُ رُضْعٍ، وَ بَهَائِمُ رُتْعٍ،
لَجَعَلْتُ السَّمَاءَ مِنْ فَوْقِكُمْ حَدِيدًا، وَ الْأَرْضَ صَفْصَفًا،
وَ التُّرَابَ رَمَادًا، وَ لَمَا أَنْزَلْتُ عَلَيْكُمْ مِنَ السَّمَاءِ قَطْرَةً، وَ
لَمَا أَنْبَتُ فِي الْأَرْضِ مِنْ حَبَّةٍ، وَ لَصَبَبْتُ عَلَيْكُمْ
الْعَذَابَ صَبًّا

"O njeri! Sa e sa kandila i ka shuar era (fryma) e epshit! Sa të devotshëm ekzistojnë që i ka shkatërruar mendjemadhësia (vetëpëlqimi)! Sa e sat të pasur (pasanikë) i ka shkatërruar pasuria e tyre, e sa e sa varfanjakë i ka shkatërruar varfëria e tyre! Sa e sa njerëz të shëndoshë i ka shkatërruar shëndeti i tyre!

Sa e sa të ditur (dijetarë) i ka shkatërruar dituria, e të paditur (injorantë) mosdija e tyre! Sikur të mos ekzistonin të moshuar që bëjnë ruku, të rinj që sillen me përulësi, fëmijë që thithin gji dhe kafshët në kullota – qiellin mbi ju do ta shndërroja në hekur, tokën në shkretëtirë, e pluhurin në hi! Nuk do t'ju dërgoja as një pikë shiu, e as që toka do t'i mbinte farërat, por mbi ju do ta derdhja dënimin!

Këshilla e katërmëdhjetë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! اطْلُبُونِي بِقَدْرِ حَاجَتِكُمْ إِلَيَّ،
وَاعْصُونِي بِقَدْرِ صَبْرِكُمْ عَلَى النَّارِ، وَلَا تَنْظُرُوا إِلَيَّ
أَجَالِكُمُ الْمُسْتَأْخِرَةَ، وَأَرْزَاقِكُمُ الْحَاضِرَةَ، وَذُنُوبِكُمُ
الْمُسْتَتِرَةَ ﴿كُلُّ شَيْءٍ هَالِكٌ إِلَّا وَجْهَهُ﴾ لَهُ الْحُكْمُ
وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿الْقَصَص: 88﴾

"O bijtë e Ademit! Më kërkoni aq sa ju duhem, jini të padëgjueshëm ndaj meje aq sa mund ta duroni Zjarrin! Mos u mbështetni dot në shtyrjen e çastit të vdekjes (exhelit), në fatin që keni dhe në mëkatet që i fshihni, ngase: **'Gjithçka shkatërrohet – përpos Fytyrës së Tij! Atij i takon gjykimi dhe tek Ai do të ktheheni ju!'**"⁸

⁸ El-Kasas, 88. Në suren Er-Rahman i Lartmadhërishmi thotë: **"Çdo gjë që gjendet në Tokë është e kalueshme (do të shkatërrohet), *dhe mbetet vetëm Fytyra e Zotit tënd, të Madhërishmit dhe Bujarit!"** (26, 27).

Këshilla e pesëmbëdhjetë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! إِنَّ صَلَاحَ دِينِكَم وَ لَحْمُكُمْ وَ دَمُكُمْ، صَلَاحَ عَمَلُكُمْ وَ لَحْمُكُمْ وَ دَمُكُمْ، وَإِنْ فَسَدَ دِينُكُمْ فَسَدَ عَمَلُكُمْ وَ لَحْمُكُمْ وَ دَمُكُمْ فَلَا تَكُنْ كَالْمُصْبَاحِ يَخْرُقُ نَفْسَهُ وَ يُضَيِّئُ لِلنَّاسِ، وَ أَخْرِجْ حُبَّ الدُّنْيَا مِنْ قَلْبِكَ، فَإِنِّي لَا أَجْمَعُ حُبَّ الدُّنْيَا وَ حُبِّي فِي قَلْبٍ وَاحِدٍ أَبَدًا، وَ ارْفُقْ بِنَفْسِكَ فِي جَمْعِ الرِّزْقِ، فَإِنَّ الرِّزْقَ مَقْسُومٌ، وَ الْحَرِيصَ مَحْرُومٌ، وَ الْبَخِيلَ مَذْمُومٌ، وَ النِّعْمَةَ لَا تَدُومُ، وَ الْإِسْتِقْصَاءَ شَوْمٌ، وَ الْأَجَلَ مَعْلُومٌ، وَ الْحَقَّ مَعْلُومٌ، وَ خَيْرَ حِكْمَةِ اللَّهِ الْخُشُوعُ، وَ خَيْرَ الْفَنَاءِ الْقِنَاعَةُ، وَ خَيْرَ الزَّادِ التَّقْوَى، وَ خَيْرَ مَا أَتَى فِي الْقُلُوبِ الْيَقِينُ، وَ خَيْرَ مَا أُعْطِيتُمُ الْعَافِيَةُ

"O bijtë e Ademit! Nëse e keni në rregull besimin tuaj dhe trupin tuaj, në rregull do t'i keni edhe veprat tuaja dhe trupin tuaj! E, nëse nuk e keni në rregull besimin tuaj, të parregullta do të jenë edhe veprat tuaja dhe trupi juaj! Mos u bëni porsi kandili,

i cili vetveten e djeg, e të tjerëve u bën dritë! Flakni (nxirrni jashtë) nga zemra juaj dashurinë ndaj dunjallëkut, meqë Unë kurrë nuk i bashkoj në një zemër dashurinë edhe ndaj dunjallëkut edhe ndaj Meje! Jini të kujdesshëm ndaj vetes suaj gjatë tubimit (grumbullimit) të riskut, ngase risku është ndarë (caktuar) kurse lakmuesi është i privuar e koprraci i poshtëruar, ndërsa dhuntia është e pakalueshme, të pyeturit e tepruar është fatkeqësi, e çasti i vdekjes (do të vijë) dhe e vërteta janë të njohura! Frika nga Allahu paraqet kulmin e mençurisë, kënaqësia është pasuria më e madhe, ndërsa devotshmëria është furnizimi më i mirë!⁹ Më e dobishmja që mund të hyjë në zemër është besimi i patundshëm (*jekin*), e më e mira që ju është dhënë është shëndeti! "

⁹ Në suren *El-Bekare*, ajeti 197 qëndron: "...e furnizimi më i mirë është devotshmëria! Prandaj, Ma kini frikën, or mendarë!"

Këshilla e gjashtëmbëdhjetë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: ﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لِمَ تَقُولُونَ مَا لَا تَفْعَلُونَ﴾ (الصف: 2) وَ كَمْ تَقُولُونَ وَ تَخْلِفُونَ، وَ كَمْ تَنْهَوْنَ عَمَّا لَسْتُمْ عَنْهُ تَنْتَهُونَ، وَ كَمْ تَأْمُرُونَ وَ لَا تَفْعَلُونَ، وَ كَمْ تَجْمَعُونَ مَا لَا تَأْكُلُونَ، وَ كَمْ تَوْبَةِ يَوْمًا بَعْدَ يَوْمٍ تُؤَخَّرُونَ، عَمَّا بَعْدَ عَامٍ ثُمَّ لَمْ تَنْظُرُونَ، أَعِنْدَكُمْ مِنَ الْمَوْتِ أَمَانٌ؟ أَمْ بِيَدِكُمْ بَرَاءَةٌ مِنَ النَّارِ؟ أَمْ تَحَقَّقْتُمُ الْفُوزَ بِالْجَنَانِ؟ أَمْ بَيْنَكُمْ وَ بَيْنَ الرَّحْمَنِ رَحْمَةٌ؟ أَبْطَرْتُمْ النِّعَمَ، وَ أَفْسَدْتُمُ الْإِحْسَانَ، وَ غَرَّكُمْ مِنَ الدُّنْيَا طُولُ الْأَمَلِ. وَ لَا تَغْتَنِمُوا الصِّحَّةَ وَ السَّلَامَةَ، فَأَيُّامُكُمْ مَعْلُومَةٌ، وَ أَنْفُسُكُمْ مَعْدُودَةٌ، وَ قَدِّمُوا لِأَنْفُسِكُمْ لِمَا بَقِيَ فِي أَيْدِيكُمْ. يَا بَنَ آدَمَ! إِنَّكَ تَقْدُمُ عَلَى عَمَلِكَ، وَ إِنَّ كُلَّ يَوْمٍ يَهْدِمُ مِنْ عُمْرِكَ، مِنْ يَوْمٍ خَرَجْتَ مِنْ بَطْنِ أُمِّكَ، وَ تَدْنُو كُلَّ يَوْمٍ مِنْ قَبْرِكَ حَتَّى تَدْخُلَهُ. يَا بَنَ آدَمَ! مِثْلُكُمْ فِي

الدُّنْيَا كَمَثَلِ الدُّبَابِ، كُلَّمَا وَقَعَ فِي الْعَسَلِ انْتَشَبَ فِيهِ،
فَكَذَلِكَ أَنْتَ، لَا تَكُنْ كَالْحَطْبِ الَّذِي يَحْرَقُ نَفْسَهُ
لِغَيْرِهِ بِالنَّارِ

"O besimtarë, përse flisni atë që nuk e punoni?"¹⁰ Sa e sa gjëra që i flisni, e së këndejmi i nuk i përfillni ato! Sa e sa gjëra i ndaloni, e vetë nuk nguroni nga ato! Sa e sa gjëra i urdhëroni, e vetë nuk i zbatoni ato! Sa shumë gjëra grumbulloni e nuk i hani! Sa e sa vështirësi nga dita në ditë dhe nga viti në vit i prolongoni, e, atëherë, çfarë prisni? A mos vallë ju jeni të liruar nga vdekja? Ose ndofta keni garanci nga Zjarri? Apo mos ju janë garantuar kopshtet e Xhenetit? A mos vallë mes jush dhe Rrahmanit ju është garantuar mëshira? Begatia ju ka bërë juve fodull, bamirësia ju ka shkatërruar, ndërsa kundrejt dunjallëkut ju ka mashtruar shpresa! Mos t'ju robërojnë shëndeti dhe siguria, ngase ditët tuaja janë të caktuara dhe jeta e kufizuar. Përgatitni për vete të mirat që kanë mbetur në duart tuaja! O njeri! Ti je duke shkuar përballë veprave tuaja! Që kur ke dalë nga barku i nënës tënde për çdo ditë je duke u shembur (flashkur) dhe për çdo dit po i afrohesh varrit, gjithnjë derisa nuk hyn në të! O njerëz!

¹⁰ *Es-Saff*, 2.

Shembulli juaj në dunjallëk është sikurse mushkonnja, kurdoherë që të bie në mjaltë, ngjitet për të! Mos jini sikurse druri, i cili për shkak tjetrit, vetveten e djeg me zjarr!"

Këshilla e shtatëmbëdhjetë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنِي آدَمَ! اَعْمَلْ كَمَا أَمَرْتُكَ، وَانْتَهُ
عَمَّا نَهَيْتُكَ عَنْهُ، أَجْعَلْكَ حَيًّا لَا تَمُوتُ أَبَدًا، وَأَنَا حَيٌّ
لَا أَمُوتُ أَبَدًا، وَإِذَا قُلْتُ لِلشَّيْءِ كُنْ فَيَكُونُ. يَا بَنِي آدَمَ!
إِنْ كَانَ قَوْلُكَ مَلِيحًا، وَعَمَلُكَ قَبِيحًا، فَأَنْتَ رَئِيسُ
الْمُنَافِقِينَ؛ وَإِذَا كَانَ ظَاهِرُكَ مَلِيحًا وَبَاطِنُكَ قَبِيحًا،
فَأَنْتَ مِنَ الْهَالِكِينَ. يَخَادِعُونَ اللَّهَ وَهُوَ خَادِعُهُمْ،
﴿وَمَا يَخْدَعُونَ إِلَّا أَنْفُسَهُمْ وَمَا يَشْعُرُونَ﴾ (البقرة: 9)
يَا بَنِي آدَمَ! لَا يَدْخُلُ الْجَنَّةَ إِلَّا مَنْ تَوَاضَعَ لِعَظَمَتِي، وَ
قَطَعَ النَّهَارَ بِذِكْرِي، وَكَفَّ نَفْسَهُ عَنِ الشَّهَوَاتِ مِنْ
أَجَلِي؛ فَإِنِّي آوَى الْغَرِيبِ وَأُؤَمِّنُ الْفَقِيرَ، وَأَكْرِمُ الْيَتِيمَ،
وَأَكُونُ لَهُ كَالْأَبِ الرَّحِيمِ، وَلِلْأَرَامِلِ كَالزَّوْجِ الْعُطُوفِ
الشَّفُوقِ. فَمَنْ كَانَتْ هَذِهِ صِفَتُهُ كُنْتُ مُجِيبًا لَهُ، إِذَا
دَعَانِي شَيْئًا أَسْتَجِيبُهُ، وَإِذَا سَأَلَنِي أَعْطَيْتُهُ

"O njeri! Vepro ashtu siç të kam urdhëruar dhe shmangiu asaj që ta kam ndaluar – do të bëj që të jeshë gjallë përgjithmonë! Unë jam i Amshueshmi, i Gjalli, Ai i Cili nuk vdes kurrë, e kur t'i them diçkaje 'Bëhu' – ajo bëhet!"¹¹ O njeri! Nëse të folmen e ke të ëmbël, e veprat e shëmtuara, atëherë je udhëheqës i hipokritëve, e, nëse pamjen e jashtme e ke të bukur, e brendinë të neveritshme, atëherë ke dështuar (je gremisur)! Të këtillët tentojnë ta mashtrojnë All-llahun, e All-llahu do t'i ndëshkojë ata: **"...edhe pse, duke mos e vërejtur këtë, e mashtrojnë vetveten."**¹² O njeri! Në Xhennet do të hyjë vetëm ai që i nënshtrohet Madhërisë Sime, kush më kujton gjatë ditës dhe kush, për hir Timin, braktis epshin. Unë i jap strehë vetmitarit, siguri varfanjakut, i qeras bonjakët – duke vepruar ndaj tyre si baba i mëshirshëm, kurse ndaj të vejave sikundër burrë i ndjeshëm! Kushdo që i ka këto veti, kur të Më thërrasë, do t'i përgjigjem atij, e kur të Më lutet për diçka, do t'ia jap atë! "

¹¹ Në suren *En-Nahël*, 40 i Lartmadhërishmi thotë: **"Nëse dëshirojmë të bëhet diçka, Ne — vetëm i themi asaj: 'Bëhu!' dhe ajo bëhet. "**

¹² *El-Bekare*, 9.

Këshilla tetëmbëdhjetë!

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! إِلَى مَنْ تَشْكُونِي وَ لَيْسَ لِمِثْلِي تَشْكُو؟ وَ إِلَى مَتَى تَنْسُونِي وَ لَمْ أُسْتَوْجِبْ مِنْكُمْ ذَلِكَ؟ وَ إِلَى مَتَى تَكْفُرُونِي وَ لَسْتُ بِظَلَامٍ لِلْعَبِيدِ؟ وَ إِلَى مَتَى تَجْحَدُ نِعْمَتِي؟ وَ إِلَى مَتَى تَسْتَحَفُّ بِكِتَابِي، وَ لَمْ أُكَلِّفْكَ مَا لَا تُطِيقُ؟ وَ إِلَى مَتَى تَجْهَرُونِي؟ وَ إِلَى مَتَى تَجْحَدُونِي وَ لَيْسَ لَكُمْ رَبٌّ غَيْرِي؟ وَ إِذَا مَرَضْتُمْ فَأَيُّ طَبِيبٍ مِنْ دُونِي يَشْفِيكُمْ؟ فَقَدْ شَكَوْتُمُونِي وَ سَخَطْتُمْ قَضَائِي، وَ أَنَا الَّذِي أَرْسَلْتُ السَّمَاءَ عَلَيْكُمْ مِدْرَارًا فَقَلْتُمْ مُطِرْنَا بِهَذَا النَّجْمِ، فَقَدْ كَفَرْتُمُونِي وَ آمَنْتُمْ بِالنَّجْمِ، وَ أَنَا الَّذِي أَنْزَلْتُ عَلَيْكُمْ رَحْمَتِي قَدْرًا مَقْدُورًا مَكِينًا مَعْدُودًا مَوْزُونًا مَقْسُومًا، فَإِذَا جَاءَ أَحَدَكُمْ قُوْتٌ ثَلَاثَةَ أَيَّامٍ، قَالَ: أَنَا بِشَرٍّ وَ لَسْتُ بِخَيْرٍ، فَقَدْ جَحَدَ نِعْمَتِي، وَ مَنْ مَنَعَ الزَّكَاةَ مِنْ مَالِهِ فَقَدْ اسْتَحَفَّ بِكِتَابِي، وَ إِذَا عَلِمَ بِوَقْتِ الصَّلَاةِ لَمْ يَفْرُغْ لَهَا فَقَدْ غَفَلَ عَنِّي

"O njeri! Si t'i ankohesh dikujt kundër Meje, kur nuk ekziston askush që t'i ankohesh kundër Meje? Deri kur më do të Më harrosh, e Unë, për këtë shkak, nuk do të të përgjigjem? Deri kur më do të jeshë mosmirënjohës ndaj Mej, e Unë nuk jam zullumqar (tiran) kundrejt robërve të Mi?¹³ Deri kur do t'i mohosh dhuntitë e Mia? Deri kur do të jeshë mospërfillës ndaj Librit Tim? Unë nuk të të kam ngarkuar me atë që nuk mund ta durosh! Deri kur do t'Më shmangesh e t'Më mohosh, e pos Meje, ju Zot tjetër nuk keni? Kur të sëmureni cili – përpos Meje – do t'ju shërojë?¹⁴ Ju ankoheni në Mua dhe urdhrat e mi i përbuzni, e Unë jam Ai që jua dërgon shiun, dhe ju sërish thoni: 'Shiu na ka rënë për shkak të këtij a atij ylli!'¹⁵ A mos vallë Mua më mohoni e në yje

¹³ "...dhe Unë nuk jam zullumqar i robërve të Mi. " (Kaf, 29.)

¹⁴ "E kur të sëmurem, Ai më shëron." (Esh-Shu'ara', 80)

¹⁵ Zejd b. Halid Xhuhemi transmeton: "I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. e fali namazin e sabahut me ne në Hudejbije, pas shiut që kishte rënë atë natë. Kur e kreu namazin, iu kthye njerëzve dhe tha: 'A e dini ju se çfarë thotë Zoti juaj?' 'All-llahu dhe i Dërguari i Tij e dinë këtë! – u përgjigjën ata. Atëherë i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: 'Robërit e Mi kanë gëdhirë si besimtarë dhe si jobesimtarë. Kush thotë: 'Shiu na ka rënë me mëshirën e All-llahut', ai beson në Mua dhe mohon fuqinë e yjeve, e, ai që thotë: 'Shiu na ka rënë duke iu falënderuar këtij a atij ylli', ai nuk beson në Mua dhe beson në yje.'"

besoni, e Unë jam që jua dërgoj me masë mëshirën Time! Dhe kur t'ju vijë furnizim i mjaftueshëm për tri ditë, ju thoni: 'Ne jemi në bela e jo në të mirë', duku mohuar kështu dhuntinë Time! Kush kundërshton të japë zekatin nga pasuria e vet, ai e ka mospërfillur Librin Tim, e kush e di se kur është koha e namazit, e nuk e kryen atë, ai është i pakujdesshëm ndaj Meje! "

Hadithin e transmeton Muslimi, "*Iman*" – 125; Buhariu, "*Istiska*" – 28; Ahmedi, 4/117; Ebu Davudi, "*Tib*" – 22; Nesa'iu, "*Istiska*" – 16.

Nesa'iu e transmeton edhe me një rivajet nga Ebu Hurejre, i cili është më i shkurtër se i Zejd b. Halidit, me këtë tekst: "I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: '*All-llahu i Lartmadhërishëm ka thënë: 'Nuk u kam dërguar robërve të Mi dhuntinë (shiun), e që dikush prej tyre të mos gëdhijë si jobesimtarë, duke thënë: 'Shiu na ka rënë për shkak të këtij a atij ylli!'*'"

Hadithin e shënon edhe Imam Ahmedi, 1/89, 108, 131.

Tirmidhiu në kaptinën "*Komentimi i sures El-Uaki'a*", shënon transmetimin nga Aliu r.a. se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. e ka cituar ajetin: "***Dhe, në vend të falënderimit që keni furnizimin tuaj, ju, në të vërtetë, edhe e mohoni këtë***", dhe ka thënë: "Shiu na ka rënë për shkak të këtij a atij ylli!?"

Këshilla e nëntëmbëdhjetë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! اصْبِرْ وَ تَوَاضِعْ أَرْفَعَكَ،
 وَ اشْكُرْنِي أَرْدَكَ، وَ اسْتَغْفِرْنِي أَغْفِرْ لَكَ، وَ إِذَا دَعَوْتَنِي
 أَسْتَجِيبُ لَكَ، وَ تُبِّ إِلَيَّ أَتُبُّ عَلَيْكَ، وَ اسْأَلْنِي أُعْطِكَ،
 وَ تَصَدَّقْ أَبَارِكْ لَكَ فِي رِزْقِكَ، وَ صِلْ رَحِمَكَ أَرِدْ فِي
 أَجْلِكَ، وَ اطْلُبْ مِنِّي الْعَافِيَةَ بِطُولِ الصَّحَّةِ، وَ السَّلَامَةَ
 فِي الْوَحْدَةِ، وَ الْإِخْلَاصَ فِي الرَّغْبَةِ، وَ الْوَرَعَ إِلَى اللَّهِ
 فِي التَّوْبَةِ، وَ الْغَنَاءَ فِي الْقَنَاعَةِ. يَا بَنَ آدَمَ! كَيْفَ تَطْمَعُ
 فِي الْعِبَادَةِ مَعَ الشُّبْعِ؟ وَ كَيْفَ تَطْمَعُ فِي حُبِّ اللَّهِ مَعَ
 حُبِّ الْمَالِ؟ وَ كَيْفَ تَطْمَعُ فِي الْخَوْفِ مَعَ خَوْفِ
 الْفَقْرِ؟ وَ كَيْفَ تَطْمَعُ فِي الْوَرَعِ مَعَ الْحِرْصِ عَلَى الدُّنْيَا؟
 وَ كَيْفَ تَطْمَعُ فِي مُرْضَاةِ اللَّهِ بِغَيْرِ الْمَسَاكِينِ؟ وَ كَيْفَ
 تَطْمَعُ فِي الرِّضَا مَعَ الْبُخْلِ؟ وَ كَيْفَ تَطْمَعُ فِي الْجَنَّةِ مَعَ
 حُبِّ الدُّنْيَا وَ مَعَ الْمَدْحِ؟ وَ كَيْفَ تَطْمَعُ فِي السَّعَادَةِ مَعَ
 قَلَّةِ الْعِلْمِ؟

"O njeri! Ji i durueshëm dhe i bindur, do ta rris autoritetin tënd! M'u falëndero Mua, do të jap edhe më shumë! Kërko nga Unë falje, do të të fal, e kur më drejtohesh do të të përgjigjem! Kërko ndjesë nga Unë për mëkatet, do të të fal, do ta pranojë pendimin! Kërko nga Unë, do të të dhuroj! Jep sadaka, do t'i jap bereket furnizimit tënd! Ruaj lidhjet farefisnore, do ta shtoj jetën! Kërko nga unë të mira në shëndet të vijueshëm, siguri në vetmi, singëritet në zellshmëri, devotshmëri gjatë mynxyrave dhe begati në kënaqësi! O njeri! Si mund të jeshë i ngopur, e të gjakosh për ibadet? Si mund të jeshë njëkohësisht i mallëngjyer për dashurinë e All-llahut dhe për pasurinë? Si gjakon e lakmon frikën (nga All-llahu), e ke frikë nga varfëria? Si është e mundur që ta dëshirosh devotshmërinë, e së këndejmi ke lakmi të pangopshme ndaj dunjallëkut? Si është e mundur që ta dëshirosh kënaqësinë e All-llahut, e nuk u ndihmon të varfërve? Si mund të gjakosh për kënaqësinë Time, e së këndejmi je koprrac? Si është e mundur që ta dëshirosh Xhennetin, e e do dunjallëkun dhe mburrjen? Si mund ta kërkosht lumturinë e botës tjetër me pak dituri? "

Këshilla e njëzetë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا أَيُّهَا النَّاسُ! لَا عِشَ كَالْتَدْبِيرِ، وَلَا
وَرَعَ كَالْكَفِّ عَنِ الْأَذَى، وَلَا حُبَّ أَرْفَعُ مِنَ الْأَدَبِ، وَلَا
لَا شَفِيعَ كَالْتَوْبَةِ، وَلَا عِبَادَةَ كَالْعِلْمِ، وَلَا صَلَاةَ
كَالْخَشْيَةِ، وَلَا ظَفَرَ كَالصَّبْرِ، وَلَا سَعَادَةَ كَالْتَوْفِيقِ، وَلَا
لَا زَيْنَ أَزَيْنَ مِنَ الْعَقْلِ، وَلَا رَفِيقَ آنَسُ مِنَ الْحِلْمِ. يَا بَنَ
آدَمَ! تَفَرَّغْ لِعِبَادَتِي أَمْلَأُ قَلْبَكَ غِنًى، وَأُبَارِكَ فِي رِزْقِكَ،
وَأُحِلَّ فِي جِسْمِكَ رَاحَةً، وَلَا تَغْفَلَ عَنْ ذِكْرِي، فَإِنْ
غَفَلْتَ أَمْلَأُ قَلْبَكَ فَقْرًا، وَبَدَنَكَ تَعَبًا وَنَصَبًا، وَصَدْرَكَ
هَمًّا، وَلَوْ أَبْصَرْتَ مَا بَقِيَ مِنْ عُمرِكَ لَزَهَدْتَ فِيمَا بَقِيَ
مِنْ أَمْلِكَ. يَا بَنَ آدَمَ! بِعَافِيَتِي قَوِّتَ عَلَى طَاعَتِي، وَ
بِتَوْفِيقِي أَدَيْتَ فَرِيضَتِي، وَبِرِزْقِي قَوِّتَ عَلَى مَعْصِيَتِي،
بِمَشِيئَتِي تَشَاءُ مَا تَشَاءُ، وَبِإِرَادَتِي تُرِيدُ مَا تُرِيدُ لِنَفْسِكَ،
وَبِنِعْمَتِي قُمْتَ وَقَعَدْتُ وَرَجَعْتُ، وَبِكُنْفِي أُمْسَيْتَ

وَأُصْبِحْتَ، وَفِي فَضْلِي عِشْتَ، وَفِي نِعْمَتِي تَقَلَّبْتَ،
وَبِعَافِيَّتِي تَجَمَّلْتَ؛ ثُمَّ تَنْسَانِي وَتَذْكُرُ غَيْرِي، فَلِمَ لَا
تُؤَدِّي حَقِّي وَشُكْرِي؟

"O njerëz! Nuk ka jetë pa planifikim, e as devotshmëri pa u përmbajtur nga shqetësimi i besimtarëve! Nuk ka bukuri më të bukur sesa edukata e bukur, e as ndërmjetës më të mire sesa teubeja (pendimi)! Nuk ka ibadet siç është dijenia, as namaz siç është frikë-respekti! Nuk ka fitore më të madhe sesa sabri, e as lumturi më të madhe sesa udhëzimi! Nuk ka stoli më të madhe sesa arsyeja (mendja), e as mik më të mirë sesa karakteri (vetia) e mirë! O njeri! Plotësoje ibadetin ndaj Meje – zemrën do të ta mbush me begati, do t'i jap bereket furnizimit tënd dhe rehati trupit tënd! Mos e lë pas dore vërejtjen Time, meqë, nëse e bën këtë, do ta mbushë zemrën me varfëri, trupin me lodhje, e gjoksin do ta mbush me brenga! Sikur të mundje, o njeri, të shihje se sa të ka mbetur nga jeta, do të hezitoje nga mbetja e çdo shprese! O njeri! Falë mbështetjes Sime, ti ke fuqi të Më bindesh, me ndihmën Time ti i kryen farzet e Mia, e me furnizimin Tim ti ke fuqi që t'Më jeshë i padëgjueshëm, me fuqinë Time ti bënë çfarë të duash. Me dëshirën Time ti dëshiron atë që dëshiron, me dhuntinë Time ti ngrihesh (qohesh), ulesh dhe

lëviz, nën mbrojtjen Time ti flen dhe zgjohesh, në bollëkun Tim, ti jeton, në dhuntinë Time ti kënaqesh, me bamirësinë Time, ti zbukurohesh, dhe përkundër të gjitha këtyre ti prapë se prapë Mua më harron, e dikë tjetër e përmend!? Përse nuk i përmbush të drejtat e Mia dhe, përse nuk Më je mirënjohës? "

Këshilla e njëzetënjetë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! الْمَوْتُ يَكْشِفُ أَسْرَارَكَ، وَ الْقِيَامَةُ تَبْلُو أَخْبَارَكَ، وَالْعَذَابُ يَهْتِكُ أَسْرَارَكَ، فَإِذَا أَذْنَبْتَ ذَنْبًا فَلَا تَنْظُرْ إِلَى صِغَرِهِ، وَ لَكِنْ انْظُرْ إِلَى مَنْ عَصَيْتَ، وَ إِذَا رُزِقْتَ رِزْقًا قَلِيلًا فَلَا تَنْظُرْ إِلَى قِلَّتِهِ، وَ لَكِنْ انْظُرْ إِلَى مَنْ رَزَقَكَ؛ وَ لَا تَحْقِرِ الذَّنْبَ الصَّغِيرَ، فَإِنَّكَ لَا تَدْرِي بِأَيِّ ذَنْبٍ عَصَيْتَهُ؛ وَ لَا تَأْمَنُ مِنْ مَكْرِي، فَإِنَّ مَكْرِي أَخْفَى عَلَيْكَ مِنْ دَيْبِ النَّمْلِ عَلَى الصِّفَا فِي اللَّيْلَةِ الْمُظْلِمَةِ. يَا بَنَ آدَمَ! هَلْ عَصَيْتَنِي فَذَكَرْتَ غَضَبِي؟ وَ هَلْ انْتَهَيْتَ عَمَّا نَهَيْتُكَ؟ وَ هَلْ أَدَّيْتُ فَرِيضَتِي كَمَا أَمَرْتُكَ؟ وَ هَلْ وَاسَيْتَ الْمَسَاكِينَ مِنْ مَالِكَ؟ وَ هَلْ أَحْسَنْتَ إِلَى مَنْ أَسَاءَ إِلَيْكَ؟ وَ هَلْ عَفَوْتَ عَمَّنْ ظَلَمَكَ؟ وَ هَلْ وَصَلْتَ مَنْ قَطَعَكَ؟ وَ هَلْ أَنْصَفْتَ مَنْ خَانَكَ؟ وَ هَلْ كَلَّمْتَ مَنْ هَجَرَكَ؟ وَ هَلْ أَدَّبْتَ وَلَدَكَ؟

وَهَلْ أَرْضَيْتَ جِيرَانَكَ؟ وَهَلْ سَأَلْتَ الْعُلَمَاءَ عَنْ أَمْرِ
 دِينِكَ وَدُنْيَاكَ؟ فَإِنِّي لَا أَنْظُرُ إِلَى صُورَتِكُمْ، وَلَا إِلَى
 مَحَاسِنِكُمْ، وَلَكِنْ أَنْظُرُ إِلَى قُلُوبِكُمْ، وَأَرْضَى بِهِذِهِ
 الْخِصَالِ مِنْكُمْ

"O njeri! Vdekja do ti zbulojë fshehtësitë tuaja, Dita e Gjykimit do ti bëjë të njohura botërisht lajmet e tua, ndërsa ndëshkimi do ta nxjerrë në shesh turpin tënd! Andaj, kur të bësh ndonjë mëkat, mos e konsidero atë si cikërrimë, porse mendohu mirë se ndaj kujt ke mëkatuar! Nëse je furnizuar me pak furnizim, mos e konsidero atë si të vogël, porse përqendrohu në atë se kush të ka furnizuar! Mos i përçmo lehtë mëkatet e vogla, meqë ti nuk e di se me çfarë mëkati je ngarkuar! Mos ji i sigurt nga ndëshkimi Im, ngase ai është më i fshehtë sesa zvarritja e buburrecit nëpër shkrepin shkëmbor në natën e errët! O njeri! A të bie ndër mend hidhërimi Im kur bën ndonjë mëkat ndaj Meje? A ke pushuar së bëri atë që e kam ndaluar? A po i kryen farzet e Mia ashtu siç të kam urdhëruar? A e ke ngushëlluar me pasurinë tënde ndonjë varfanjak? A po sillesh mirë me atë që ndaj teje është i keq? A po ia falë atij që të ka bërë ndonjë padrejtësi? A po e mirëmban lidhjen me atë që e ka ndërprerë këtë me ty? A je i

drejtë ndaj atij që të ka tradhtuar (zhgënjyer)? A flet me atë që të shmanget ty? A e ke edukuar mirë fëmijën tënd? Fqinjët e tu a janë të kënaqur me ty? A po i pyet të diturit për çështjet e fesë dhe për detyrimet e tua? Unë, me të vërtetë, nuk po i vështroj pamjet tuaja, e as bukurinë tuaj, por po i vështroj zemrat¹⁶ tuaja dhe jam i kënaqur nëse i keni cilësitë e përmendura! "

¹⁶ Në hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejre, qëndron se, i Dërguari i All-llahut s.a.v.s., ka thënë: *"Me të vërtetë All-llahu Nuk shikon në trupat tuaj, e as në pamjet tuaja, porse shikon në zemrat tuaja."* Shënon Muslimi, *"Kitabu'l-birr ue sile"* – 33; Ibën Maxhe, *"Zuhd"* – 9, Ahemdi, *Musned* – 285/549.

Këshilla e njëzetedytë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! انْظُرْ إِلَى نَفْسِكَ وَ إِلَى جَمِيعِ
 خَلْقِي، فَإِنْ وَجَدْتَ أَعَزَّ عَلَيْكَ مِنْ نَفْسِكَ، فَاصْرِفْ
 كَرَامَتَهُ إِلَيْكَ، وَ إِلَّا أَكْرِمْ نَفْسَكَ بِاتِّبَاعِ الْعَمَلِ الصَّالِحِ
 إِنْ كَانَتْ نَفْسُكَ عَلَيْكَ عَزِيزَةً. ﴿ وَاذْكُرُوا نِعْمَةَ اللَّهِ
 عَلَيْكُمْ وَمِيثَاقَهُ الَّذِي وَاثَقَكُمْ بِهِ إِذْ قُلْتُمْ سَمِعْنَا
 وَأَطَعْنَا ﴾ (المائدة: 7) وَ اتَّقُوا اللَّهَ قَبْلَ يَوْمِ الْقِيَامَةِ، يَوْمَ
 التَّعَابِنِ، يَوْمِ الْحَاقَّةِ، ﴿ يَوْمٍ كَانَ مِقْدَارُهُ خَمْسِينَ أَلْفَ
 سَنَةٍ ﴾ (المعارج: 4) ﴿ هَذَا يَوْمٌ لَا يَنْطِقُونَ، وَلَا يُؤْذَنُ
 لَهُمْ فَيَعْتَذِرُونَ ﴾ (المرسلات: 35-36) يَوْمِ الطَّامَّةِ، يَوْمِ
 الصَّيْحَةِ ﴿ يَوْمًا عَبُوسًا قَمْطَرِيرًا ﴾ (الإنسان: 10) ﴿ يَوْمَ
 لَا تَمْلِكُ نَفْسٌ لِنَفْسٍ شَيْئًا وَالْأَمْرُ يَوْمَئِذٍ
 لِلَّهِ ﴾ (الإنفطار: 19) يَوْمِ الدَّيْمُومَةِ، يَوْمِ الزَّلْزَلَةِ، يَوْمِ
 الْقَارِعَةِ، يَوْمٍ فِيهِ تَرْجُفُ مَوَاقِعُ الْجِبَالِ، وَ حُلُولِ النَّكَالِ،

وَتَعْجِيلِ الرِّزَالِ، يَوْمَ الصَّيْحَةِ وَ الدَّرَكِ، يَوْمٍ فِيهِ تَشِيبُ
الْوِلْدَانُ، ﴿ وَلَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ قَالُوا سَمِعْنَا وَهُمْ لَا
يَسْمَعُونَ ﴾ (الأنفال: 21)

"O njeri! Përqendroje shikimin në vetvete dhe në krijesat e tjera të Mia, dhe nëse e vëren se ato janë më të zgjedhur se ti, Unë këtë nder (e cila u është dhënë atyre) do ta kaloj në ty, e nëse jo, do të të nderoj me mundësinë e pendimit, nëse merakosesh për veten! ***"Kujtoni dhuntinë e All-llahut që ju ka dhuruar juve, dhe zotimin me të cilin ju ka ngarkuar Ai, kur patët thënë: "Dëgjuam dhe u bindëm!"***¹⁷ Dhe kini frikë All-llahun para se të vijë Dita e Gjykimit, Dita e vetëmashtimit dhe Dita e pashmangshme, ***"masa e së cilës është pesëdhjetë mijë vjet"***¹⁸ ***"Kjo është Dita kur ata nuk do të flasin, e as që do t'u lejohet të kërkojnë falje!"***¹⁹ Kjo është dita e fatkeqësisë më të madhe (et-tammeh), dhe dita e klithjes (sajhah), dhe ***"Dita kur fytyrat do të jenë të ngrysurat e të vrenjtura."***²⁰, dhe ***"Dita kur shpirti shpirtit nuk do të mund t'i ndihmojë aspak, atë Ditë pushtet do të ketë vetëm***

¹⁷ El-Ma'ide, 7.

¹⁸ El-Me'arixh, 4.

¹⁹ El-Murselat, 35-36.

²⁰ El-Insan, 10.

All-llahu.²¹ Dita e zgjatjes (*dejmumeh*), dhe Dita e Kiametit (*kari'a*), dhe Dita në të cilën do të lëvizin malet, dhe Dita e Tërmetit (*zelzele*), Dita kur ndëshkimi do të njëmendësohet dhe shkatërrimi do të shpejtohet, dhe Dita e britmave dhe e arritjes (*derek*), dhe Dita që fëmijët do t'i bëj të thinjur! Prandaj **“mos u bëni si ata që thonë: “Ne dëgjojmë”! — por ata, (në të vërtetë), nuk dëgjojnë.”**²²

²¹ *El-Infitar*, 19.

²² *El-Enfal*, 21.

Këshilla e njëzetetretë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: ﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَذْكُرُوا اللَّهَ ذِكْرًا
كَثِيرًا﴾ (الأحزاب: 41-42) يَا مُوسَى بْنُ عِمْرَانَ،
يَا صَاحِبَ الْبَيَانِ، اسْمَعْ كَلَامِي! فَأَنَا اللَّهُ الْمَلِكُ
الدَّيَّانُ، لَيْسَ بَيْنِي وَبَيْنَكَ تَرْجُمَانٌ، بَشَرٌ أَكِلَ الرَّبِّ
بِغَضَبِ الرَّحْمَنِ، وَ مُضَعَّفَاتِ النَّيْرَانِ. يَا بَنَ آدَمَ! إِذَا
وَجَدْتَ قَسَاوَةً فِي قَلْبِكَ، وَ سَقَمًا فِي بَدَنِكَ، وَ حِرْمَانًا
فِي رِزْقِكَ، وَ نَقِصَةً فِي مَالِكَ، فَاعْلَمْ بِأَنَّكَ تَكَلَّمْتَ بِمَا
لَا يَعْينِكَ. يَا بَنَ آدَمَ! مَا يَسْتَقِيمُ دِينُكَ حَتَّى يَسْتَقِيمَ
لِسَانُكَ، وَ لَا يَسْتَقِيمَ لِسَانُكَ حَتَّى تَسْتَحْيِيَ مِنْ رَبِّكَ.
يَا بَنَ آدَمَ! إِذَا نَظَرْتَ فِي عُيُوبِ النَّاسِ وَ نَسِيتَ عَيْبَكَ،
فَقَدْ أَرْضَيْتَ الشَّيْطَانَ وَ أَغْضَبْتَ الرَّحْمَنَ. يَا بَنَ آدَمَ!
لِسَانُكَ أَسَدٌ، إِنْ أَطْلَقْتَهُ قَتَلَكَ، فَهَلَاكُكَ فِي إِطْلَاقِ
لِسَانِكَ

“O besimtarë, përmendni shpesh All-llahun, dhe lavdëroni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje!”²³

O Musa, i biri i Imranit! Dëgjo mirë se çfarë po të them: Unë ja All-llahu, Sundimtari dhe Zoti, ndërmjet Meje dhe teje nuk ka ndërmjetës! Përgëzoje me pezmin e Rrahmanit dhe zjarrin e shumëfishtë atë që merr kamatë! O njeri! Nëse vëren mizori (pamëshirë) në zemrën tënde, sëmundje në trupin tënd, mungesë në furnizim dhe në pasuri, atëherë, dije se po flet atë që nuk ka të bëjë me ty (nuk të intereson)! O njeri! Besimi yt nuk do të jetë i drejtë derisa nuk e përmirëson gjuhën tënde, e nuk do ta përmirësosh gjuhën tënde përderisa nuk turpërohesh nga Zoti yt! O njeri! Derisa i sheh të metat e njerëzve të tjerë, e tuat i harron, po e kënaq shejtanin dhe po e nxit pezmin e Rrahmanit! O njeri! Gjuha jote është luan, nëse e liron do të të vrasë! Shkatërrimi yt prehet në lirim të tij!”

²³ *El-Ahzab*, 41.-42.

Këshilla e njëzetekatërt

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! ﴿٦٨﴾ إِنَّ الشَّيْطَانَ لَكُمْ عَدُوٌّ
فَاتَّخِذُوهُ عَدُوًّا ﴿٦٩﴾ (الفاطر: 6) اَعْلَمُوا الْيَوْمَ الَّذِي
تُحْشَرُونَ فِيهِ فَوْجًا فَوْجًا، وَ تَقُومُونَ بَيْنَ يَدَيِ الرَّحْمَنِ
صَفًّا صَفًّا، وَ تَقْرَأُونَ الْكِتَابَ حَرْفًا حَرْفًا، وَ تُسْأَلُونَ عَمَّا
عَمِلْتُمْ سِرًّا وَ جَهْرًا. ﴿٧٠﴾ يَوْمَ نَحْشُرُ الْمُتَّقِينَ إِلَى الرَّحْمَنِ
وَفِدًّا، وَ نَسْوَقُ الْمُجْرِمِينَ إِلَى جَهَنَّمَ وَرِدًّا ﴿٧١﴾ (مريم:
85-86) لَكُمْ وَعْدٌ وَ وَعِيدٌ، فَإِنِّي أَنَا اللَّهُ لَا شَبِيهَ لِي،
وَ لَيْسَ سُلْطَانٌ كَسُلْطَانِي. مَنْ صَامَ لِي فِي دَهْرِهِ خَالِصًا
أَفْطَرْتُهُ بِاللَّوَانِي، وَ مَنْ بَاتَ فِي لَيْلِهِ قَائِمًا كَانَ لَهُ شَأْنٌ مِنْ
شَأْنِي، وَ مَنْ غَضَّ عَيْنَهُ عَن مَحَارِمِي أَمْنَتْهُ مِنْ نِيرَانِي.
فَأَنَا الرَّبُّ فَاعْرِفُونِي، وَ أَنَا الْمُنْعِمُ فَاشْكُرُونِي، وَ أَنَا
الْحَافِظُ فَاحْفَظُونِي، وَ أَنَا النَّاصِرُ فَانصُرُونِي، وَ أَنَا الْعَافِرُ
فَاسْتَغْفِرُونِي، وَ أَنَا الْمَقْصُودُ فَاقْصِدُونِي، وَ أَنَا الْمُعْطَى

فَاسْأَلُونِي، وَأَنَا الْمَعْبُودُ فَاعْبُدُونِي، وَأَنَا الْعَالِمُ
فَاخْذَرُونِي

"O bijtë e Ademit! Djalli, me të vërtetë, është armiku juaj, andaj merreni atë për armik!²⁴ Kijeni në mendje atë Ditë, në të cilën, grupe-grupe, do të tuboheni ju, dhe në të cilën do të qëndroni në rreshta (safe) para Rrahmanit, dhe kur do ta lexoni Librin shkronjë më shkronjë, dhe kur do të pyeteni për atë që keni punuar qoftë fshehurazi qoftë haptazi! ***"E në Ditën kur do t'i tubojmë të devotshmit te Mëshiruesi si mysafirë, *dhe kur kriminelët do t'i fusim të etur në Xhehennem!"***²⁵ Para jush është kërcënimi dhe premtimi, e Unë jam All-llahu, me të Cilin asgjë nuk është i ngjashëm, e as që dikush ka pushtet mbi pushtetin Tim! Kush agjëron sinqerisht për hir Timin, do t'ia përgatis atij iftarin nga enët e Mia, e kush bën natën ibadet, do t'i dhuroj atij pjesëmarrje nga nderi (dinjiteti) Im! Kush e ul shikimin e vet nga ajo që ia kam ndaluar, do të jetë i sigurt nga zjarri Im! Un jam Zoti, prandaj Më perceptoni ju, Unë jam Shpërblyesi – Më falënderoni, Unë jam Ruajtësi – Më ruani Mua, Unë jam Ndhimësi – Më ndihmoni ju, Unë jam Ai që i fal mëkatet – lutmuni për falje,

²⁴ *Fatir*, 6.

²⁵ *Merjem*, 85.-86.

Unë jam Ai që kërkohet – Më kërkoni ju, Unë jam
Ai që adhurohet – adhuromëni ju, Unë jam i
Gjithëdijsmi – ruajuni nga Unë!

Këshilla e njëzetepestë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! ﴿ شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُوا الْعِلْمِ قَائِمًا بِالْقِسْطِ ۚ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ، إِنَّ الدِّينَ عِنْدَ اللَّهِ

الْإِسْلَامُ ﴿ (آل عمران: 18-19) ﴿ وَمَنْ يَتَّبِعْ غَيْرَ الْإِسْلَامِ

دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ

الْخَسِرِينَ ﴿ (آل عمران: 85) وَ بَشَّرَ كُلَّ شَيْءٍ أَحْسَنَ

بِالْجَنَّةِ. وَ مَنْ عَرَفَ اللَّهَ خَالِصًا فَاطَّاعَهُ نَجَا، وَ مَنْ

عَرَفَ الشَّيْطَانَ فَعَصَاهُ سَلِمَ، وَ مَنْ عَرَفَ الْحَقَّ فَاتَّبَعَهُ

أَمِنَ، وَ مَنْ عَرَفَ الْبَاطِلَ فَاتَّقَاهُ فَازَ، وَ مَنْ عَرَفَ .

الشَّيْطَانَ وَ الدُّنْيَا ثُمَّ رَفَضَهُمَا سَعِدَ، وَ مَنْ عَرَفَ الْآخِرَةَ

ثُمَّ طَلَبَهَا هُدِيَ. وَ إِنَّ اللَّهَ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ وَ إِلَيْهِ

تُقْلَبُونَ. يَا بَنَ آدَمَ! إِذَا كَانَ اللَّهُ تَعَالَى قَدْ تَكَفَّلَ لَكَ

بِالرِّزْقِ، فَطُوبَى لِمَاذَا؟ وَ إِذَا كَانَ الْخَلْفُ مِنْ

اللَّهُ فَالْبُخْلُ لِمَآذَا؟ وَإِذَا كَانَ إِبْلِيسُ عَدُوَّ اللَّهِ تَعَالَى
فَالْعَفْلَةُ لِمَآذَا؟ وَإِذَا كَانَتِ الْعُقُوبَةُ بِالنَّارِ، فَلِإِسْتِرَاحَةٍ
لِمَآذَا؟ وَإِذَا كَانَ ثَوَابُ اللَّهِ الْجَنَّةَ، فَالْمَعْصِيَةُ لِمَآذَا؟
وَإِذَا كَانَ كُلُّ شَيْءٍ بِقَضَائِي فَالْجَزَعُ لِمَآذَا؟ ﴿لِكَيْلَا
تَأْسَوْا عَلَى مَا فَاتَكُمْ وَلَا تَفْرَحُوا بِمَا آتَاكُمْ﴾ وَاللَّهُ لَا
يُحِبُّ كُلَّ مُخْتَالٍ فَخُورٍ ﴿(الحديد: 23)

"O bijtë e Ademit! ***"All-llahu dëshmon se nuk ka zot tjetër përveç Tij, por edhe engjëjt e të diturit, dhe se Ai vepron drejtësisht. Nuk ka zot tjetër përveç Tij., të Fuqishmit e të Urtit! *Feja e All-llahut është me të vërtetë Islami!..."***²⁶ ***"E, ai që dëshiron fe tjetër përveç Islamit, ajo nuk do t'i pranohet dot, dhe ai në botën tjetër do të jetë ndër të ngadhënjyerit."***²⁷ Ai, i Lartmadhërishmi, çdo gjë që punohet në mënyrë të përkryer e ka përgëzuar me Xhennet. Kush e percepton All-llahun sinqerisht dhe i bindet Atij – do të jetë i shpëtuar, e, nëse e percepton shejtanin dhe e kundërshton atë – do të jetë i sigurt! Kush e percepton të Vërtetën dhe e pason atë – do të jetë i mbrojtur, e, nëse e percepton

²⁶ Ali Imran, 18.-19.

²⁷ Ali Imran, 85.

lajthitjen duke u ruajtur nga ajo – do të ketë sukses! Kush e percepton shejtanin dhe dynjallëkun, e pastaj i braktis ata, është fatlum, e, nëse e percepton ahiretin, pastaj e dëshiron (e kërkon) atë - ai është i udhëzuar! Me të vërtetë All-llahu e përudh në rrugë të drejtë kë të dojë Vetë dhe Atij do t'i ktheheni ju! O njeri! All-llahu tanimë ta ka siguruar riskun, andaj përse brengosesh aq shumë? Nëse shpërblimin e ke nga All-llahu, atëherë përse koprracia? Nëse Iblisi është armiku i All-llahut, atëherë përse pakujdesia? Nëse ndëshkimi është Zjarri, atëherë përse rehatllëku? Nëse shpërblimi nga All-llahu është Xhenneti, atëherë përse mëkatimi? Nëse çdo gjë prehet në përcaktimin e All-llahut, atëherë përse frika? ***“Për të mos u dëshpëruar për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos n gëzuar së tepërmi për atë që ju ka dhënë Ai juve...”***²⁸

²⁸ El-Hadid, 23.

Këshilla e njëzetegjashtë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! أَكْثِرُوا مِنَ الزَّادِ فَإِنَّ الطَّرِيقَ
بَعِيدٌ، وَ جَدِّ الْقِيَامَ لِلَّهِ فَإِنَّ الْبَحْرَ عَمِيقٌ، وَ حَقَّقُوا
الْعَمَلَ فَإِنَّ الصِّرَاطَ دَقِيقٌ، وَ أَخْلِصِ الْفِعْلَ فَإِنَّ النَّاقِدَ
بَصِيرٌ. فَشَهَوَاتِكَ فِي الْجَنَّةِ، وَ رَاحَتِكَ إِلَى الْآخِرَةِ،
وَ لَدَيْكَ الْحُورُ الْعِينُ، وَ كُنْ لِي أَكُنْ لَكَ، وَ تَقَرَّبْ إِلَيَّ
فِي هَوَانِ الدُّنْيَا وَ حُبِّ الْأَبْرَارِ، فَإِنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ أَجْرَ
الْمُحْسِنِينَ

"O bijtë e Ademit! Rriteni fondin e shpenzimeve për rrugë, ngase rruga është shumë e gjatë! Rimëkëmbni ibadetin ndaj All-llahut, ngase deti është shumë i thellë! Shqyrtoni veprat tuaja, ngase Sirati është shumë i hollë! Veproni me sinqeritet, ngase Ai ju vështron përherë! Kënaqësia juaj është në Xhennet, ndërsa rehatllëku në ahiret! Juve ju takojnë hyritë symëdha! Jini me Mua, e Unë do të jem me ju! Mu afroni, ashtu që të jeni mospërfillës ndaj dunjallëkut dhe duke i dashur të ndershmit! Me të vërtetë All-llahu nuk do të lejojë që t'i shkatërrohet shpërblimi i bamirësve! "

Këshilla e njëzeteshtatë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! كَيْفَ تَعْصُونَ وَ أَنْتُمْ
تَجْرَعُونَ مِنْ حَرِّ الشَّمْسِ، وَ جَهَنَّمَ لَهَا سَبْعُ طَبَقَاتٍ،
فِيهَا نِيرَانٌ يَأْكُلُ بَعْضُهَا بَعْضًا، فِي كُلِّ مِنْهَا سَبْعُونَ أَلْفَ
شُعْبٍ مِنَ النَّارِ، فِي كُلِّ شُعْبٍ سَبْعُونَ أَلْفَ دَارٍ، وَ فِي
كُلِّ دَارٍ سَبْعُونَ أَلْفَ بَيْتٍ، وَ فِي كُلِّ بَيْتٍ سَبْعُونَ أَلْفَ
بَيْتٍ، وَ فِي كُلِّ بَيْتٍ سَبْعُونَ أَلْفَ تَابُوتٍ مِنَ نَارٍ، وَ فِي كُلِّ
تَابُوتٍ سَبْعُونَ أَلْفَ عَقْرَبٍ مِنَ نَارٍ، عَلَى كُلِّ تَابُوتٍ
سَبْعُونَ أَلْفَ شَجَرَةٍ مِنْ زُقُومٍ تَحْتَ كُلِّ شَجَرَةٍ سَبْعُونَ
أَلْفَ قَائِدٍ مِنَ نَارٍ، مَعَ كُلِّ قَائِدٍ سَبْعُونَ أَلْفَ مَلَكٍ مِنْ
نَارٍ، وَ سَبْعُونَ أَلْفَ تُعْبَانٍ مِنَ نَارٍ، طُولُ كُلِّ تُعْبَانٍ
سَبْعُونَ أَلْفَ ذِرَاعٍ مِنَ نَارٍ، فِي جَوْفِ كُلِّ تُعْبَانٍ بَحْرٌ مِنَ
السَّمِّ الْأَسْوَدِ، وَ لِكُلِّ عَقْرَبٍ أَلْفَ ذَنْبٍ، طُولُ كُلِّ ذَنْبٍ
سَبْعُونَ أَلْفَ ذِرَاعٍ، فِي كُلِّ ذَنْبٍ سَبْعُونَ أَلْفَ رِطْلٍ مِنَ

السَّمِّ الْأَحْمَرِ، فَيَنْفَسِي أَخْلِفُ، ﴿ وَالطُّورِ، وَكِتَابِ
 مَسْطُورٍ، فِي رَقٍّ مَنشُورٍ، وَالْبَيْتِ الْمَعْمُورِ، وَالسَّقْفِ
 الْمَرْفُوعِ، وَالْبَحْرِ الْمَسْجُورِ ﴾ (الطور: 1-6) يَا بَنِي آدَمَ! مَا
 خَلَقْتُ النَّيِّرَانَ إِلَّا لِكُلِّ كَافِرٍ، وَنَمَامٍ، وَعَاقٍ الْوَالِدَيْنِ،
 وَ الْمُرَائِي، وَ مَانِعِ الزَّكَاةِ مِنْ مَالِهِ، وَ الزَّانِي، وَ آكِلِ
 الرِّبَا، وَ شَارِبِ الْخَمْرِ، وَ ظَالِمِ الْيَتِيمِ، وَ الْأَجِيرِ الْغَادِرِ،
 وَ النَّائِحَةِ، وَ لِكُلِّ مُؤَذَى الْجِيرَانِ، ﴿ إِلَّا مَنْ تَابَ وَآمَنَ
 وَعَمِلَ عَمَلًا صَالِحًا فَأُولَئِكَ يُبَدِّلُ اللَّهُ سَيِّئَاتِهِمْ حَسَنَاتٍ ۖ
 وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَحِيمًا ﴾ (الفرقان: 70) فَارْحَمُوا
 أَنْفُسَكُمْ يَا عِبَادِي! فَإِنَّ الْأَبْدَانَ ضَعِيفَةٌ، وَ السَّفَرُ بَعِيدٌ،
 وَ الْحِمْلُ ثَقِيلٌ، وَ الصِّرَاطُ دَقِيقٌ، وَ النَّاقِدُ بَصِيرٌ، وَ
 الْقَاضِي رَبُّ الْعَالَمِينَ

"O bijtë e Ademit! Si është e mundur që të mëkatonit (gaboni), e së këndejmi ia keni frikën vapës (nxehhtësisë) së diellit!? Xhehennemit i ka shtatë nivele, në të cilat zjarret kapërdijnë njëri-tjetrin! Në secilin nivel të tij ekzistojnë nga 70 mijë rrugë të zjarrita, në çdo rrugë 70 mijë shtëpi, në çdo shtëpi 70 mijë dhoma, në çdo dhomë 70 mijë puse

(bunarë), në çdo pus 70 mijë sëndukë të zjarrtë, në çdo sënduk 70 mijë akrepa të zjarrtë, dhe në çdo sënduk 70 mijë drurë Zekkumi!²⁹ Nën çdo dru Zekkumi ka nga 70 mijë rojtarë nga zjarri, me çdo rojtar janë nga 70 mijë engjëj nga zjarri dhe 70 mijë gjarpërinj nga zjarri! Gjatësia e të cilëve është 70 mijë bërryla nga zjarri, ndërsa në barkun e secilit gjarpër gjendet një det prej helmit të zi! Kurse secili akrep ka nga një mijë bishtra, e gjatësia e çdo bishti është 70 mijë bërryla! Çdo bisht ka nga 70 mijë ritla³⁰ të helmit të kuq! Prandaj betohem me Vetën dhe ****Pasha malin e Turit (Sinait), *dhe Librin e shkruar në rreshta, *në lëkurë të ndehur, *dhe Shtëpinë me adhurues plotë, *dhe kubënë e ngritur të qiellit, *dhe detit të stërmbushur, *me të vërtetë, dënimi i Zotit tënd, do të ndodhë!***³¹ O njeri! Zjarrin e kam krijuar për çdo pabesimtar, për çdo mashtrues,

²⁹ Në suren *Es-Saffat*, 62., i Lartmadhërishmi thotë: "***A më e mirë është kjo gosti apo druri Zekum!?***" Po kështu në sure *Ed-Duhan*, 43-44 thotë: "***Me të vërtetë, druri Zekum *do të jetë ushqim i mëkatarit.***" si dhe në suren *El-Vaki'a*, 51-52: "***Dhe atëherë ju, o të humbur, që përgënjeshtroi Ringjalljen, me siguri do të hani nga druri i Zekumit!***"

³⁰ Ritl ose ratl është njësi matjeje e peshës, e cila në mjediset arabe ka vlera të llojllojshme, p.sh. në Egjipt 449,28 g., në Siri 3,202 kg. etj. (Vër. e p.b.).

³¹ *Et-Tur*, 1-7. Në origjinalin e veprës së Gazaliut, nuk është cituar ajeti 7 i kësaj sureje në hadithin-kudsij, megjithatë ne e kemi përfshirë këtu. (Vër. e p.b.).

për secilin që është i padëgjueshëm ndaj prindërve të tij, për çdo dyfytirësh (hipokrit), për secilin që nuk jep zukatin, për secilin që bën zina, për secilin që merr kamatë, për çdo alkoolist, për secilin uzurpues të bonjakëve, për secilin tregtar mashtrues, për çdo vajtues dhe për të gjithë ata që shqetësojnë fqinjin, **"Përveç atyre që pendohen, dhe besojnë, dhe punojnë vepra të mira. Këtyre, All-llahu, ua ndërron veprat e këqija në të mira. E, All-llahu është Falës e Mëshirues."**³² Mëshirojeni vetveten, o robërit e Mi! Me të vërtetë trupat janë të dobëta e rruga është e largët, barra është e rëndë kurse Sirati është i hollë. Ai ju vëzhgon juve pareshtur, e Gjykatësi jua është Zoti i botëve! "

³² *El-Furkan*,70.

Këshilla e njëzetetë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى : يَا أَيُّهَا النَّاسُ كَيْفَ رَغِبْتُمْ فِي دُنْيَا فَإِنَّ زَاوِيلَ، وَ حَيَاةٍ مُنْقَطِعَةٍ؟ فَإِنَّ لِلطَّاغِيَيْنَ الْجَنَانَ يَدْخُلُونَ مِنْ أَبْوَابِهَا الثَّمَانِيَةِ، فِي كُلِّ جَنَّةٍ سَبْعُونَ أَلْفَ رَوْضَةٍ، فِي كُلِّ رَوْضَةٍ سَبْعُونَ أَلْفَ قَصْرِ مِنَ الْيَاقُوتِ، فِي كُلِّ قَصْرِ سَبْعُونَ أَلْفَ دَارٍ مِنَ الزُّمُرُودِ، فِي كُلِّ دَارٍ سَبْعُونَ أَلْفَ بَيْتٍ مِنَ الذَّهَبِ الْأَحْمَرِ، فِي كُلِّ بَيْتٍ سَبْعُونَ أَلْفَ مَقْصُورَةٍ مِنَ الْفِضَّةِ الْبَيْضَاءِ، فِي كُلِّ مَقْصُورَةٍ سَبْعُونَ أَلْفَ مَائِدَةٍ مِنَ الْغُبْرِ، عَلَى كُلِّ مَائِدَةٍ سَبْعُونَ أَلْفَ صَحْفَةٍ مِنَ الْجَوَاهِرِ، فِي كُلِّ صَحْفَةٍ سَبْعُونَ أَلْفَ لَوْنٍ مِنَ الطَّعَامِ، حَوْلَ كُلِّ مَقْصُورَةٍ سَبْعُونَ أَلْفَ سَرِيرٍ مِنَ الذَّهَبِ الْأَحْمَرِ، عَلَى كُلِّ سَرِيرٍ سَبْعُونَ أَلْفَ فِرَاشٍ مِنَ الْحَرِيرِ وَ الْإِسْتَبْرَقِ وَ الدِّيَنَاجِ، حَوْلَ كُلِّ سَرِيرٍ سَبْعُونَ أَلْفَ نَهْرٍ مِنْ مَاءِ الْحَيَاةِ وَ اللَّبَنِ وَ الْعَسَلِ وَ الْخَمْرِ، فِي

وَسَطِ كُلِّ نَهْرٍ سَبْعُونَ أَلْفَ لَوْنٍ مِنَ الثَّمَارِ، فِي كُلِّ بَيْتٍ
 سَبْعُونَ أَلْفَ خِيْمَةٍ مِنَ الْأَرْجُوانِ، عَلَى كُلِّ فِرَاشٍ حَوْرَاءُ
 مِنَ الْخُورِ الْعَيْنِ، بَيْنَ يَدَيْهَا سَبْعُونَ أَلْفَ وَصِيفَةٍ كَأَنَّهُنَّ
 بَيْضٌ مَكْنُونٌ، عَلَى رَأْسِ كُلِّ قَصْرِ سَبْعُونَ أَلْفَ قُبَّةٍ، فِي
 كُلِّ قُبَّةٍ سَبْعُونَ أَلْفَ هَدِيَّةٍ مِنَ الرَّحْمَنِ، مَا لَا عَيْنٌ رَأَتْ،
 وَلَا أُذُنٌ سَمِعَتْ، وَلَا خَطَرَ عَلَى قَلْبٍ بَشَرٍ، ﴿وَفَاكِهَةٍ
 مِّمَّا يَتَخَيَّرُونَ، وَلَحْمِ طَيْرٍ مِّمَّا يَشْتَهُونَ، وَخُورٍ عَيْنٍ،
 كَأَمْثَلِ الثَّلْثِيِّ الْمَكْنُونِ، جَزَاءً بِمَا كَانُوا
 يَعْمَلُونَ﴾ (الواقعة: 20-24) لَا يَمُوتُونَ فِيهَا وَلَا
 يَهْرُمُونَ، وَلَا يَحْزَنُونَ وَلَا يَصُومُونَ، وَلَا يُصَلُّونَ، وَلَا
 يَمْرَضُونَ، وَلَا يَبُولُونَ وَلَا يَتَغَوَّطُونَ ﴿وَمَا هُمْ مِنْهَا
 بِمُخْرَجِينَ﴾ (الحجر: 48) فَمَنْ طَلَبَهَا وَذَكَرَ كَرَامَتِي،
 وَجَوَارِي وَنِعْمَتِي، فَلْيَتَقَرَّبْ إِلَيَّ بِالصَّدَقِ، وَالْإِسْتِهَانَةِ
 بِالْدُّنْيَا، وَالْفَنَاعَةِ بِالْقَلِيلِ

"O njerëz! Si mund të lakmoni dynjallëkun e
 paqëndrueshëm dhe jetën kalimtare? Me të vërtetë
 atyre që janë të dëgjueshëm u takojnë Xhenetet, në
 të cilat do të hyjnë nga tetë dyer të Xhenetit. Në çdo

Xhenet janë 70 mijë kopshte, në çdo kopsht janë 70 mijë pallate prej margaritarësh, në çdo pallat 70 mijë shtëpi prej smeraldi, në çdo shtëpi 70 mijë dhoma prej flori të kuq, në çdo dhomë 70 mijë të ndara (kthina) prej argjendi të bardhë, në çdo të ndarë 70 mijë sofra bojëhiri, në çdo sofër 70 mijë enë prej gurë të çmuar, e në çdo enë 70 mijë lloje gjellësh! Përreth çdo kthine janë 70 mijë shtretër nga floriri i kuq, në çdo shtrat 70 mijë shtroja prej mëndafshi, armaçi dhe kadifeje. Përreth çdo shtrati gjenden 70 mijë lumenj nga Uji i Jetës, qumështi, mjalti dhe vera, në mes të çdo lumi gjenden 70 mijë lloje frutash! Në çdo dhomë gjenden 70 mijë tenda prej pëlhure purpuri! Në çdo shtrat ndodhen hyritë symëdha, ndër to gjenden 70 mijë vajza sikur të ishin inxhi të bardha! Në majë të çdo pallati gjenden 70 kube, e në çdo kube 70 mijë dhurata nga Rrahmani, që syri i njeriut nuk i ka parë dot, veshi nuk ka dëgjuar dhe zemrës as që i ka rënë ndër mend! ***'Dhe pemë të cilat do t'i zgjedhin vetë, * dhe mish të shpendëve çfarë ju ka ënda *Në to (Xhennete) ka edhe hyri symëdha, *si të ishin margaritarë të fshehur - si shpërblim për ato çfarë kanë punuar ata.***³³ Në to (Xhennete) njerëzit nuk do të vdesin e as që do të plaken, nuk do të pikëllohen e as që do të agjërojnë, nuk do të falen e as që do të sëmuren. Aty nuk do të bëjnë as nevojën

³³ *El-Vaki'a*, 20-24.

e vogël as të madhen,³⁴ e as që do të dalin prej atyre.³⁵ Pra, ai i cili i kërkon këto dhe përmend nderimet e Mia, fqinjësinë Time dhe dhuntitë e Mia, le të Më afrohet me sinqeritet, duke mospërfillur dynjallëkun dhe duke u kënaqur me pak gjë. "

³⁴ Shih hadithin e Ebu Hurejres në: *Sahihu'l-Buhari*, "Kitabu bed'i'l-halk", 8; *Sahih Muslim*, "Kitabu'l-xhenneti ue sifeti ne'imiha ue ehliha", 15, 16,17; *Musnedin e Imami Ahmedit*, 2/232, 253, 316; *Sunenin e Tirmidhiut*, "Kitabu sifeti'l-xhenneh", 7; *Sunenin Ibn Maxhes*, "Kitabu zuhd", 39; v. Po kështu hadithin nga Xhabir b. Abdullahu në: *Musnedin e Imami Ahmedit*, 3/316, 349, 354, 364, 384; *Musnedin e Darimiut*, "Kitabu'r-rikak", 104.

³⁵ "***Aty nuk do t'i çik (prek lehtas) lodhja, ata prej aty nuk do të dëbohen kurrë!***" (*El-Hixhër*, 48.)

Këshilla e njëzetënëntë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: يَا بَنَ آدَمَ! الْمَالُ مَالِي وَ أَنْتَ عَبْدِي،
 فَمَا لَكَ مِنْ مَالِي إِلَّا مَا أَكَلْتَ فَأَفْنَيْتَ، أَوْ لَبِسْتَ
 فَأَبْلَيْتَ، أَوْ تَصَدَّقْتَ فَأَبْقَيْتَ. فَأَنَا وَ أَنْتَ ثَلَاثَةُ أَقْسَامٍ:
 فَوَاحِدٌ لِي، وَ وَاحِدٌ لَكَ، وَ وَاحِدٌ بَيْنِي وَ بَيْنَكَ؛ فَأَمَّا
 الَّذِي لِي فَرُوحُكَ، وَ أَمَّا الَّذِي لَكَ فَعَمَلُكَ، وَ أَمَّا الَّذِي
 بَيْنِي وَ بَيْنَكَ، فَمِنْكَ الدُّعَاءُ وَ مِنِّي الإِجَابَةُ. يَا بَنَ آدَمَ!
 تَوَرَّعْ وَ اقْنَعْ تَرْنِي، وَ اعْبُدْنِي تَصِرْ إِلَيَّ، وَ اطلُبْنِي
 تَجِدْنِي. يَا بَنَ آدَمَ! إِذَا كُنْتَ مِثْلَ الْأُمَرَاءِ الَّذِينَ دَخَلُوا
 النَّارَ بِالْفُجُورِ، وَ الْعَرَبِ بِالْمَعْصِيَةِ، وَ الْعُلَمَاءِ بِالْحَسَدِ،
 وَ التُّجَّارِ بِالْخِيَانَةِ، وَ الْجَبَرِيَّةِ بِالْجَهَالَةِ، وَ الصُّنَّاعِ
 وَ الْعَبَادِ بِالرِّيَاءِ، وَ الْأَغْنِيَاءِ بِالْكِبَرِ، وَ الْفُقَرَاءِ بِالْكَذِبِ،
 فَأَيْنَ مَنْ يَطْلُبُ الْجَنَّةَ؟

"O njeri! E gjithë pasuria më përket Mua, e ti je robi Im! Nga pasuria Ime ty të mbetet vetëm ajo që e ha, e atë e harxhon, ose veshmbathja, e ato i gris duke i përdorur, ose jep (ndan) sadaka (lëmoshë), e

kjo të mbetet! Ndërmjet Meje dhe teje janë tri ndarje: njëra më takon Mua, e dyta të takon ty dhe e treta më takon edhe Mua edhe ty! Mua më takon shpirti yt, ty të takojnë veprat e tua dhe ty të takon dua e Mua përgjigjja! O njeri! Ji i devotshëm dhe i kënaqur – do të Më shohësh! Më bëj ibadet – do të Më arrishë! Më kërko – do të Më gjeshë! O njeri! Nëse bëhesh sikur udhëheqësit e prishur, beduinët e padëgjueshëm, ulemaja ziliqare, tregtarët e prishur, dhunuesit injorantë, punëtorët dhe të devotshmit hipokritë, pasanikët mburravecë dhe, varfanjakët e rrejshëm – do të hyshë në Xhehennem! Atëherë ku është ai që e kërkon Xhennetin!? "

Këshilla e tridhjetë

يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: ﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ
تُقَاتِهِ ۖ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ
مُسْلِمُونَ﴾ (آل عمران: 102) يَا بَنِي آدَمَ! إِنَّمَا مَثَلُ الْعِلْمِ
بِلَا عَمَلٍ كَمَثَلِ الْبَرْقِ وَالرَّعْدِ بِلَا مَطَرٍ، وَ مَثَلُ الْعَمَلِ بِلَا
عِلْمٍ كَمَثَلِ شَجَرَةٍ بِلَا ثَمَرَةٍ، وَ مَثَلُ الْعَالِمِ بِلَا عَمَلٍ
كَمَثَلِ قَوْسٍ بِلَا وَتَرٍ، وَ مَثَلُ الْمَالِ بِلَا زَكَاةٍ كَمَثَلِ مَنْ
يَزْرَعُ الْمِلْحَ عَلَى الصَّفَا، وَ مَثَلُ الْمَوْعِظَةِ عِنْدَ الْأَحْمَقِ
كَمَثَلِ الدُّرِّ وَالْجَوَاهِرِ عِنْدَ الْبَهَائِمِ، وَ مَثَلُ الْقَاسِي مَعَ
الْعِلْمِ كَمَثَلِ حَجَرٍ بَاقِعٍ. وَ مَثَلُ الْمَوْعِظَةِ عِنْدَ مَنْ لَا
يَرْغَبُ فِيهَا كَمَثَلِ الْمِزْمَارِ عِنْدَ الْقُبُورِ، وَ مَثَلُ الصَّدَقَةِ مِنْ
الْحَرَامِ كَمَثَلِ مَنْ يَغْسِلُ الْقَدَرَ عَلَى ثَوْبِهِ بِبَوْلِهِ، وَ مَثَلُ
الصَّلَاةِ بِلَا زَكَاةٍ كَمَثَلِ جُثَّةٍ بِلَا رُوحٍ، وَ مَثَلُ الْعَالِمِ بِلَا

تَوْبَةٍ كَمَثَلِ الْبِنَاءِ بِلَا أَسَاسٍ، ﴿أَفَأَمِنُوا مَكْرَ اللَّهِ ۚ فَلَا يَأْمَنُ مَكْرَ اللَّهِ إِلَّا الْقَوْمُ الْخَاسِرُونَ﴾ (الأعراف: 99)

"O besimtarë! - Druajuni All-llahut ashtu si duhet T'i druani dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!" ³⁶ O njeri! Dituria pa vepra është sikundër rrufeja pa shi; vepra pa dituri është sikundër pema pa fruta; shembulli i dijetarit pa vepra është sikundër harku pa tërkuzë; shembulli i pasurisë, nga e cila nuk jepet zekati, është sikundër shembulli i atij që mbjell kripë në gurë; këshilla e drejtuar ahmakut është e ngjashme me margaritarë dhe gurë të çmuar para bagëtisë së trashë; njeriu me zemër të vrazhdë që di, i ngjan gurit të lagur; ³⁷ këshilla e atij i cili nuk lakmon për të (këshillën) i ngjan instrumentit muzikor pranë varrezave; ³⁸ shembulli i sadakasë nga harami është sikundër shembulli i atij që i pastron rrobat me shurrë; ³⁹

³⁶ Ali Imran, 102.

³⁷ Me këtë dëshirohet të thuhet se në njeriun me zemër të vrazhdë nuk ndikon dituria sikundër që lagështia nuk ndikon në gur.

³⁸ Dmth. Sikundër që instrumenti muzikor nuk ndikon në të vdekur, po kështu edhe këshilla nuk ndikon në atë i cili nuk lakmon për të.

³⁹ Sikundër që rrobat nuk pastrohen me shurrë, po kështu edhe pasuria haram nuk pastrohet me sadaka.

namazi pa zekat është sikundër trupi pa shpirt; I dituri pa pendim (teube), i ngjason ndërtesës pa themel; ***“A mos vallë ata ndjehen të sigurt nga dënimi i All-llahut? Dënimit të All-llahut nuk i frikësohet vetëm populli të cilin e pret shkatërrimi.”***⁴⁰

⁴⁰ *El-A'raf*, 99.

Këshilla e tridhjetenjtë

